

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7333 E mërkurë 25 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës
Zhvillimet në Kinë paraqesin interes të veçantë, për shkak të peshës dhe rolit që ka në zhvillimet botërore. Nisur nga specifika e modelit ...
Vijon në faqet 20-21

Nga VASIL KURETA
Vazhdimësi apo ndryshim në Kinë



Opinion i Ditës
Cudia në lidhje me fatin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri duket se po zgjat më shumë se tri ditë. Kjo sepse kreu i qeverisë u përfshi ...
Vijon në faqen 21

Nga FERDINAND XHAFËRAJ
Perëndimi, jo me dy standarde për Edvinin



Deputeti: S'jam në hetim në Itali, kam dokumentin

Imuniteti i Tahirit, sot vendos Kuvendi, zbardhen raportet e PS dhe PD-LSI

Avokatët e ish-ministrit, letër Krimeve të Rënda: Na vini në dispozicion materialet

Nga DARINA TANUSHI

Deputeti Saimir Tahiri bëri dje publike letrën e Prokurorisë së Katanas që vërteton se në shtetin italian nuk ka asnjë hetim lidhur me emrin e tij. Duke e publikuar në një konferencë për mediat, ...

Në faqet 2-3

PAKETA FISKALE, NDRYSHON FORMULA PËR LLOGARITJEN E TAKSES SE AUTOMJETEVE

TAKSAT E MAKINAVE, SA DO TE PAGUANI NE 2018

Ministri i Financave: Shembuj konkretë për tarifat vjetore. Ndryshimet edhe për taksën mbi pronën për familjarët dhe bizneset. Skemë e re edhe për TVSH-në



(Në foto) Arben Ahmetaj, ministër i Financave dhe Ekonomisë

Në faqet 8-9

INTERVISTA NE "STUDIO E HAPUR"

Berisha: 9 miliardë euro drogë fshihen në tunelet shqiptare, e vërteta e Tahirit
Në faqen 5

INTERVISTA/ Ish-agjenti i Antidrogës: Na kërcënuan, na arrestuan një pas një të gjithëve

"Si u larguan me dhunë nga postbloku Habilajt me 'A8'"

Antonio Nazeraj: Na kërkuan ta hiqnin targën e mjetit nga raporti

Ish-agjenti i Antidrogës në Drejtorinë e Policisë Fier, Antonio Nazeraj në një intervistë të dhënë për "Gazeta Shqiptare" tregon të gjitha detajet e ndalimit të Habilajve gjatë një kontrolli për drogë dhe historinë e gjatë që ndodhi pas raportit të bërë për shefat e mëdhenj, ku iu



kërkua korrektimi dhe heqja e targës së "Audit A8" nga informacioni i dhënë. Z. Nazeraj, ju jeni një nga agjentët e Antidrogës së Drejtorisë Fier prej shumë vitesh, por u arrestuat, dënuat, liruat, e më pas larguat nga vendi, çfarë ka ndodhur? ...

Në faqet 6-7

ERMAL BINJAKU
Atentati i Mbrostarit, kapet në Kakavijë, si donte të kalonte
Në faqen 10

KOKA E GRUPIT
Arrestimi në Greqi, 'çobani': Si u përfshiva në trafikun e drogës
Në faqen 11

EVENTI
"Tetori gjerman", Meta: Kultura krijon lidhjet më të forta mes vendeve
Në faqen 4

LISTA E PERDITISUAR
Pronarët në Shkodër, kush është kompensuar e statusi i pronës
Në faqet 18-19

DOSJA HABILAJ REAGIMET

"Trafiku i drogës me mbështetjen e atyre që duhet ta luftojnë"

Kryeprokurori Llalla: prokurorët janë të pavarur, as unë nuk mund të ndërhyj

Prokurori i përgjithshëm, Adritaik Llalla, tha dje se prokurorët janë zot të çështjes dhe askush nuk mund t'i ndërhyjë. Në përfundim të takimit të zhvilluar nga ambasada franceze me temë "Lufta kundër trafikimit të lëndëve narkotike", kreu i akuzës tha se askush nuk mund të ndërhyjë në punën e prokurorit, pasi është vetë prokurori i çështjes, që vlerëson ecurinë e hetimit. "Prokuroria do të ndjekë hapat procedurale, në detyrën e prokurorit të përgjithshëm është detyrimin moral dhe institucional që të mbështesë veprimet e të gjithë prokurorëve", u shpreh kryeprokurori. Sipas tij, "prokurorët janë të pavarur dhe tashmë pas ndryshimeve në reformën në drejtësi, prokurori është



ULSI MANJA
"Deklarata politike si ajo e djeshmja në mënyrë kategorike jo, e jo më të sulmojnë Kryeministrin që mban një fjalim politik në një forum të partisë së tij", tha Manja.

vetë zoti i çështjes, pra në këtë kuptim askush nuk ndërhy në punën e prokurorit, përfshi edhe mua. Çdo hetim vlerësohet vetë prej prokurorit të çështjes për mënyrën si do organizojnë

dhe drejtojnë hetimet". "Është shumë e rëndësishme që prokurori në çdo rast të zhvillojë hetimet i pandikuar dhe i pafrikësuar edhe në ato raste kur subjekte të hetimit janë zyrtarë apo ish-zyr-

tarë të lartë. Në fund të fundit, ky është standardi ndërkombëtar që Shqipëria synon t'i përafrohet dhe ne besojmë se të gjithë bashkë do të punojmë që këto standarde të arrihen në një kohë sa më të shpejtë", tha në fjalën e tij, Llalla. Sipas tij, "hetimet e Antimafies italiane së fundmi kanë siguruar të dhëna se grupe kriminale shqiptare kanë trafikuar drejt Italisë, tonelata lëndë narkotike kanabis dhe në shumë raste kjo është realizuar me mbështetjen e individëve që kanë për detyrë goditjen e këtij krimi të rëndë".



Avokatët e deputetit, letër Krimeve të Rënda: Na vini në dispozicion materialet e çështjes

Tahiri: S' jam në hetim në Itali, kam dokumentin

"Nëse ka deputetë të PS që mendojnë që duhet të arrestohem, të votojnë"

Darina Tanushi

Deputeti Saimir Tahiri bëri dje publike letrën e Prokurorisë së Katanas që vërteton se në shtetin italian nuk ka asnjë hetim lidhur me emrin e tij. Duke e publikuar në një konferencë për mediat, Tahiri ngriti shqetësimin se Prokuroria shqiptare donte ta arrestonte me 48 orë letra gazetash. "Për çmimin e së vërtetës, jam i gatshëm të paguaj gjithçka jam e kam. As dua të ma falë kush të drejtën time, as dua të jem peng i akujt për të vërtetën që dua ta gjej vetë, pa ndihmë e pa mbështetje politike të cilido lloji. Unë tashmë jam një qytetar pa asnjë pushtet. E si i tillë, brenda 48 orëve sigurova këtë përgjigje nga Prokuroria e Katania. Prokuroria e Katania, që ka hetuar 4 vjet një grup kriminal, e thotë shumë qartë që nuk ka asnjë lidhje me mua. E kur është kështu, si ka mundësi që prokuroria jonë, brenda 48 orëve, me letra që i morën në redaksi gazetash, kërkuar arrestimin tim", u shpreh Tahiri. "A nuk iu thanë prokurorët shqiptarë publikut se prisnin letra nga Italia? Kaq të vështirë e kish-



Faksimile e letrës së Prokurorisë Italiane Deputeti Saimir Tahiri

Nasip Naço

"Kërkesa e bërë nga prokuroria ishte një kërkesë e rëndë për zt. Tahiri, e rëndë për klasën politike që një ish-ministër i Brendshëm dhe një deputet akuzohet për vepra të rënda penale, shumë të rënda, për trafikim të lëndëve narkotike, për grup të strukturuar kriminal, vepra penale që parashikohet jo më pak se 15 vite burgim. Për rrezikshmërinë e kësaj vepre, prokuroria ka kërkuar burgim", sqaroi dje deputeti i LSI-së.

in të merrnin këtë informacion që mora unë brenda 48 orëve? Kaq të vështirë e kanë të kuptonin se 'Saimiri' që përmendet me kamion, me linjë kamionësh, që ngarkon edhe thasë droge, nuk jam e as mund të jem

unë?", sqaroi deputeti. Sipas tij, "në këtë fletë të bardhë të prokurorisë së Katania, ku hyn lufta kundër krimit e kundër drogës që kam dëgjuar të përbetohet çdo lloj race politike. Luli e Monika më të parët si kuku-

llat e shefave të tyre", tha më tej Tahiri. Ai informoi se po dje, dy avokatët e tij, Maksim Haxhia dhe Artan Hajdari i kanë dërguar një letër Prokurorisë së Krimeve të Rënda duke i kërkuar "të zhvillojë inten-

sivisht e pa ndërprerje hetimin e tij". Avokatët i kanë kërkuar po ashtu prokurorisë të njihen me materialet dhe aktet proceduese të çështjes penale. Tahiri tha dje, se nuk do të presë që kjo çështje të ngeç

"në kanalet e ndryshkura të drejtësisë, që sot mbeten në këmbë vetëm nga kanalet e pista të politikës". "Mua nuk më intereson kush arrestohet për drogë, kush arrestohet për trafik, kam luftuar vetë e do luftoj deri në fund që kjo luftë të vazhdojë. Por ju siguroj se cilado bandë kriminelësh qoftë, jo më kjo për të cilën flasin, ngjan tërësisht amatore krahasuar me bandën që ka orkestruar këtë histori, duke hedhur nga zyra partie e redaksi lajmesh bomba për publikun, fjetet e së cilës sigurisht lëvizin edhe leva të tëra institucionesh, që sot nuk janë betuar para ligjit, por para pushtetit politik", tha ai. I pyetur për pezullimin nga PS, Tahiri u shpreh se nuk ishte surprizë. "Jam i gatshëm që të hetohem, nuk i kërkoj asnjë nder ndokujt. Nëse ka deputetë që mendojnë që duhet të arrestohem, përfshirë edhe të PS, i ftoj të votojnë që të arrestohem. Mua me PS më ka bashkuar vetëm e vërteta për ta bërë këtë vend më të mirë. Unë dua të përballem me të gjithë me kokën lart, në rrugë dhe në politikë. Nëse mendojnë se kjo nuk ka lidhje me të vërtetën le të votojnë, unë do të shkojë në burg", deklaroi ai.

DEBATET NË KOMISIONIN E LIGJEVE PËR ISH-MINISTRIN TAHIRI

Alibeaj: Jo më drejtësi për qytetarët. Ky është vullneti i këtij Kuvendi. Çfarë u kuptua nga rasti "Tahiri"?
Manja: Keni një sallë poshtë për deklaratat.
Alibeaj: Vullnet politik i mazhorancës për të penguar reformën në drejtësi, siç bëte me rastin Tahiri. Ju nuk doni të bëni drejtësi. Ja mohuat drejtësisë të drejtën për të gjykuar Tahirin dhe qeverinë.
Manja: Lërimi se e ka porosi. Ta mbarojë e të iki.
Bashkim Fino: Ligji është teknik. Nuk ka të bëjë me atë që thotë PD. Alibeaj bëri politikë. Moderoni mbledhjen. Momenti i gabuar për të bërë politikë.
Alibeaj: Hapini dyert drejtësisë. Keni mundësi deri të merrkuren ta rregulloni.
Oerd Bylykbashi: Shqiptarëve u thonë 200 milionë lekë t'i mbajë gjobë y për atë që ti kërkon, aksesin në drejtësi, kurse Saimir Tahiri ia dhatë falas mbrojtjen nga drejtësia.
Gent Strazimiri: Nëse keni mbaruar të mos përmendet ky emër, të hiqni dhe nga fotografitë që ka me Edi Ramën, me partinë, ta retushoni sig e keni bërë gjithmonë, na e thoni. Vetëm diçka, merreni dhe nxirreni dhe publikisht atje, që para se të hymë këtu.
Ulsi Manja: Është çështje e jona.
Gent Strazimiri: Ai, është çështje e të gjithëve, jo vetëm e juaja.
Eduard Halimi: Po bëni një krim për të mbrojtur Tahirin, ju po bëni krim të tjerë. Vazhdoni.
Ulsi Manja: Drejtësia fillon tek raporti mjekësor dhe shkelja e drejtësisë me procedurën.
Oerd Bylykbashi: Drejtësinë falas për Saimir Tahirin (i rrah shpallullat Manjas gjatë largimit nga komisioni). Në fund, pasi deputetët demokratë e braktisën mbledhjen, socialistët miratuan të gjitha nenet e ligjit për tarifat gjyqësore.



Autorizimi ose jo i arrestimit, mazhoranca dhe opozita dorëzojnë rekomandimet

Imuniteti i Tahirit, sot vendos Kuvendi, raportet e PS dhe PD-LSI

Shumica: S'ka fakte. Pakica: Mori para nga kriminelët

Valentina Madani

Kuvendi mbledhet sot në seancë plenare, ku në rend të ditës do të jetë shqyrtimi i kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në Tiranë, "Për dhënien e autorizimit për arrestimin dhe heqjen e lirisë së deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Saimir Tahiri". Sipas njoftimit zyrtar të Kuvendit, sqarohet se në këtë pikë do të dëgjohen dy raporte nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, rekomandimi i shumicës parlamentare dhe rekomandimi i pakicës parlamentare. Më pas do të votohet nga deputetët. Në seancën e sotme në rend të ditës janë edhe "Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 12 tetor. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend. Njoftimi dhe miratimi i programit të punimeve të Kuvendit për periudhën në vijim. Njoftimi dhe miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën në vijim. Si dhe më pas, diskutime për çështje jashtë rendit të ditës deri në 60 minuta".



RAPORTI REKOMANDUES, KONKLUZIONET E DEPUTETËVE TË PS-SË

- Mbeshtetur në parimet tona kushtetuese për funksionimin e shtetit të së drejtës, barazisë së të gjithë shtetasve përpara ligjit, opinionet e Komisionit të Venecias rrethanave të parastruara nga prokuroria dhe vlerësimet të ekzistencës së motivimit politik në paraqitjen e kësaj kërkesë nga ana e prokurorisë, mosrespektimit nga ana e prokurorisë të kërkesave të nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale, ne deputetët e mazhorancës të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, i rekomandojmë Kuvendit të votojë: 1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për: Dhënien e autorizimit për kontrollin personal dhe të banesës për deputetin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Saimir Tahiri. - Dhënien e autorizimit për ndalimin e daljes jashtë shtetit, detyrimin për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, ndalimin dhe detyrimin për qëndrimin në një vend të caktuar, si masa shtrënguese të heqjes së lirisë në kuptim të gërmeve a), b), c) të nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.
- 2. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për dhënien e autorizimit për masën e arrestit në burg ose në shtëpi për deputetin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Saimir Tahiri, në kuptim të shkronjave d) dhe dh) të nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

MAZHORANCA

Mazhoranca dhe opozita dorëzuan dje në Kuvend dy raportet me rekomandimet e tyre për dhënien e autorizimit ose jo, prokurorisë për arrestimin e deputetit Saimir Tahiri. Mazhoranca pranon se parlamenti nuk ka të drejtë të gjykojë në themel kërkesën e prokurorisë, por argumenton se kërkesa duhet rrëzuar, sepse sipas tyre, ajo është "e motivuar politikisht". Kurse, deputetët e opozitës shprehën se barriera ligjore për Tahirin kompromenton imazhin e Kuvendit. Në raportin 22-faqësh të publikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, të pestë deputetët e Partisë Socialiste Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Bledar Çuçi dhe Gramoz Ruçi kërkuar rrëzimin e kërkesës së prokurorisë për arrestimin e Tahirit, por lejimin e prokurorisë që të merrte masa të tjera kufizuese për Tahirin, përfshirë autorizimin për kontroll personal dhe të banesës. Ata e argumentuan vendimin e tyre me nevojën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe me argumentin se shihnin "motive politike" të kërkesa e prokurorisë, por pa dhënë prova apo fakte dhe as

nuk shpjeguan se cilat qenë arsyet që i shtynin të mendonin se prokuroria ka një axhendë politike në këtë rast. Për mazhorancën, organi i akuzës nuk mundi të argumentojë përfshirjen e deputetit Tahiri në veprimtari kundërligjshmërie dhe nuk paraqiti asnjë indicie, fillimprova apo provë që të krijonte bindjen se ka dyshime të arsyeshme dhe të bazuara për të autorizuar vijimin e procedurave për masën ekstreme të arrestit ndaj deputetit Tahiri. "Mungesa e provave, nxitimi i organit të akuzës për të kërkuar dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë së deputetit Saimir Tahiri, dy ditë pasi ka regjistruar procedimin penal dhe emrin e tij në regjistrin e çështjeve penale, krijon bindjen se në këtë stad të hetimit që ka kryer prokuroria, ka sfond politik". Këto dhe argumente të tjera të zbardhura në këtë raport e

kanë çuar shumicën parlamentare në konkluzionin se pranojnë të japin autorizimin për kontrollin e banesës së Saimir Tahirit, moslejimin e tij të dalë jashtë shtetit dhe një sërë detyrimesh të tjera, por jo dhënien e masës arrest me burg ose në shtëpi për deputetin e Kuvendit, Saimir Tahiri. Në raportin e deputetëve të PS-së, drejtuar Kuvendit shkruhet se provat e prokurorisë nuk ishin aspak sekrete, madje kishte pasur mungesë provash e nxitim. "Kemi bindjen se hetimet e prokurorisë kanë sfond politik. E drejta e lirisë nuk cenohet me fjalë, llafe dhe dyshime, të vërtetën e presim nga këto institucione drejtësie që kemi", thuhet në raport.

OPOZITA

5 deputetët e opozitës në Këshillin për Imunitetin dorëzojnë të tjera rekomandime. Ata argumentojnë se duhet të votohet për arrestimit të

deputetit Saimir Tahiri, me qëllim që t'i hapet rrugë hetimit të plotë dhe gjithanshëm në kuadër të procedimit penal nr. 313 të vitit 2017 për veprat penale të trafikimit të lëndëve narkotike në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal dhe të korrupsionit pasiv të zyrtarëve të lartë, të parashikuara nga nenet përkatëse të Kodit Penal. Argumenti kryesor i deputetëve të opozitës është që mosdhënia e lejes do të përbëjë një barriera ligjore dhe kompromenton imazhin e Kuvendit të Shqipërisë. Duke huazuar një argument po nga raporti i "Venecias", deputetët e opozitës shkruajnë: "Maksima 'sado lart që ti të jesh, ligji është gjithnjë mbi ty' përmbyset duke u shndërruar në 'nëse je anëtar i parlamentit, ligji nuk mund të të prekë'". Raporti i opozitës u firmos nga deputetët Dhurata Çupi, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Enkelejd Alibeaj dhe Nasip Naço. "Tahiri nuk është një ish-ministër apo deputet i opozitës. Ai është një ish-ministër i qeverisë, deputet i Edi Ramës, mik i ngushtë i kryeministrit. Ai si ish-ministër jo vetëm që dyshohet se ka ndihmuar organizatën kriminale dhe ka marrë shërbime personale, por duke i vënë strukturën e shtetit në shërbim të organizatës kriminale, ai ka siguruar para për zgjedhjet". Sipas 5 deputetëve përfaqësues të opozitës, arsyeja pse duhet arresti është edhe mbrojtja e provave, të cilat janë në rrezik sipas tyre, pasi mbikëqyren nga dy miqtë e ngushtë të deputetit Tahiri, kryeministri Edi Rama dhe ministri i Brendshëm. Sipas raportit të deputetëve të opozitës, PD-së dhe LSI-së, duke marrë në mbrojtje Tahirin dëmtohen provat, pasi shkeljet e pretenduara nga prokuroria janë të rënda. "Ekziston një procedim penal i ligjshëm për Tahirin, mosdhënia e autorizimit komprometon Kuvendin dhe mosheqja e imunitetit është pengim i drejtësisë", shkruhet në raport. Gjithashtu, deputetët opozitarë janë shprehur në raportin e tyre se pretendimet e prokurorisë nuk janë të bazuara, pasi kërkesa e bërë shoqërohet me një numër të lartë provash. "Kërkesa e Prokurorisë shoqërohet me një numër të lartë provash, akuzat e ngritura nuk janë të bazuara në politike", thuhet në raportin e PD-së.

Pack



EUROPARLAMENTARJA

Europarlamentarja Doris Pack është shprehur me një sarkazmë të thellë në lidhje me kryeministrin Rama për mbrojtjen që ky i fundit ka vendosur t'i bëjë bashkëpunëtorit të tij më të ngushtë, Tahirin. "Shqipëria shtet i së drejtës? Kandidate për në BE? Kryeministri Rama po e pengon drejtësinë dhe sulmon prokurorët për të mbrojtur mikun e tij, Tahirin", shprehet ajo në një postim në "Twitter".

RAPORTI REKOMANDUES, KONKLUZIONET E DEPUTETËVE PD-LSI

■ Përfundimisht, 5 deputetët e Këshillit për Imunitetin i rekomandojnë seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të votojë për miratimin e dhënies së autorizimit, të kërkuar me kërkesën nr. 9906 prot., datë 19.10.2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda "Për dhënien e autorizimit për arrestimin, kontrollin personal dhe kontrollin e banesës së deputetit Saimir Tahiri", me qëllim për t'i hapur rrugë hetimit të plotë dhe të gjithanshëm në kuadër të procedimit penal nr. 313, të vitit 2017 për veprat penale të trafikimit të lëndëve narkotike në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal dhe të korrupsionit pasiv të zyrtarëve të lartë të parashikuara nga nenet 283/a/2, 333/a dhe 260 të Kodit Penal.

■ Tahiri nuk është një ish-ministër apo deputet i opozitës. Ai është ish-ministër i qeverisë, deputet i Edi Ramës, mik i ngushtë i kryeministrit. Ai si ish-ministër jo vetëm që dyshohet se ka ndihmuar organizatën kriminale dhe ka marrë shërbime personale, por duke vënë strukturën e shtetit në shërbim të organizatës kriminale, ai ka siguruar para për zgjedhjet.

■ Arsyeja pse duhet arresti nuk është vetëm analiza e nenit 288 të KPP, siç për një qytetar të zakonshëm, por se bëhet fjalë për mikun e kryeministrit dhe ministrit të Brendshëm aktual. Këta dy të fundit kanë nën mbikëqyryje provat dhe duke mbajtur Tahirin jashtë dhe nën mbrojtje, provat mund të dëmtohen, radarët, dëshmitarët që shohin Ramën në krah të Tahirit heshtin, bashkëpunëtorët e drejtësisë, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Pra, ka një rrezik real që bëhet me qëllim për t'i shërbyer Tahirit dhe bandës kriminale që është në hetim në Shqipëri dhe Itali. Kuvendi i Shqipërisë nuk mund të bëhet kurrë strehë e kërimit apo mbështetësve direkt të tij.

SITUATA POLITIKE REAGIMET

Kryeministri fton sipërmarrësit, linjë ajrore direkte nga Tirana

Rama në Emiratet e Bashkuara Arabe: Investoni në Shqipëri

Kryeministri Edi Rama zhvilloi dje një vizitë pune në Emiratet e Bashkuara Arabe, ku u takua me kryeministrin, Lartësinë e Tij, Sheik Mohammed bin Rashid Al Maktoum. Gjatë këtij takimi, kryeministri Rama theksoi nevojën për nxitjen e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve, si edhe ftoi sipërmarrësit e Emiratëve të Bashkuara Arabe të investojnë në Shqipëri. Me interes nga të dyja vendet shihen investimet në fushën e turizmit dhe infrastrukturës, sidomos në portet detare. Në takim u diskutua edhe



Kryeministri Edi Rama dje, një vizitë pune në Emiratet e Bashkuara Arabe

për mundësinë e vendosjes së një linje ajrore të Emiratëve të Bashkuara që të lidhë të dyja vendet. Nga

ana e tij, Lartësia e Tij, Sheik Mohammed bin Rashid Al Maktoum falënderoi kreun e qeverisë shqiptare

BASHKËPUNIMI
Kryeministri Rama theksoi nevojën për nxitjen e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve, si edhe ftoi sipërmarrësit e Emiratëve të Bashkuara Arabe të investojnë në Shqipëri.

për vizitën, si dhe shprehu gatishmërinë për të nxitur investimet në vendin tonë.



Ish-kryeministri Sali Berisha mbremë në Studio e Hapur në News 24

Presidenti merr pjesë në ekspozitën e autores gjermane, Rosemarie Trockel

Tetori gjerman', Meta: Kultura krijon lidhje të forta mes kombeve

"Bashkëpunimi mes dy vendeve është forcuar në 30 vite"

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, mori pjesë dje në ceremoninë e hapjes së ekspozitës së arteve figurative të autores gjermane, Rosemarie Trockel, e cila u zhvillua në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë. Në fjalën e tij, gjatë këtij aktiviteti që mbahet në kuadër të 'Tetorit gjerman', javëve të kulturës gjermane në Shqipëri, Presidenti Meta tha se "Tetori gjerman" është kthyer në një traditë të mrekullueshme për shqiptarët dhe se kultura krijon lidhjet më të forta dhe më afatgjata midis vendeve e kombeve. Gjithashtu, presidenti theksoi se miqësia dhe bashkëpunimi mes dy vendeve është forcuar e zgjeruar në përmasa të paimagjinueshme në 30 vitet e fundit dhe se në këto tri dekada, një rol të rëndësishëm për afrimin e njerëzve ka luajtur në mënyrë të veçantë kultura dhe arti. "Natyrish që kjo është një ngjarje tepër e rëndësishme, pasi kultura krijon lidhjet më të forta dhe më afatgjata midis vendeve dhe midis kombeve", tha Meta. "30-vjet më parë, Shqipëria po mendohej të



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, në ceremoninë e hapjes së ekspozitës së Rosemarie Trockel

hidhte hapat e para të daljes nga izolimi i gjatë dhe shkatërrues për ekonominë. Ndërsa, Republika Federale e Gjermanisë po bëhej gati të merrte përgjegjësitë, jo vetëm të bashkimit të Gjermanisë, por edhe të gjithë kontinentit evropian", u shpreh presidenti. "Me një dinamikë shumë të larmishme e të admirueshme, miqësia dhe bashkëpunimi mes dy vendeve është forcuar dhe zgjeruar në përmasa të paimagjinueshme këtu e 30 vite më parë. Padyshim që në këto tri dekada, një rol të rëndësishëm për afrimin e

njerëzve ka luajtur në mënyrë të veçantë kultura dhe arti. Kontaktet e drejtëpërdrejta mes qytetarëve dhe artistëve të të dyja vendeve janë rritur vit pas viti dhe gjermanët nuk e njohin më Shqipërinë dhe shqiptarët vetëm nga rrëfenjat dhe aventurat "fiction" të Karl May-it, i cili në fund të shekullit të 19 shkruante për vendin e shqiptarëve, pa e vizituar kurrë atë", deklaroi kreu i shtetit. "Edhe sot - vijoi presidenti - pas 30 vjet shkëmbimesh dhe bashkëpunimi të shkëlqyer në të gjitha fushat, ende shumë gjer-

manë kur dëgjojnë për Shqipërinë, vënë buzën në gaz dhe kujtojnë vitet e hershme kur mësonin për shqiptarët përmes novelës së May-it. Shkëmbimet kulturore janë rritur, kontaktet e drejtëpërdrejta, e jo vetëm të albanologëve apo studiuesve të specializuar nga të dyja vendet janë intensifikuar. Sot, me qindra të rinj shqiptarë mësojnë me dashuri e përkushtim gjuhën dhe kulturën gjermane, por po ashtu shumë të rinj gjermanë interesohen më shumë për atë që ofron Shqipëria, si në aspektin gjeografik e turistik, ashtu edhe në atë historik e kulturor. Numri i të rinjve gjermanë që vizitojnë vendin tonë është rritur ndjeshëm dhe po kështu, edhe artistë të zhanreve të ndryshme po performojnë gjithnjë e më shumë në skenat dhe ekspozitat shqiptare", vijoi Meta. "Jam i sigurt se pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së re kulturore mes dy vendeve, edhe në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës së Shqipërisë, por edhe aktorëve të tjerë të fushës, bashkëpunimi kulturor mes dy vendeve do të pasurohet akoma më shumë", tha Meta.

Kreu i PPE, Daul: Krimi e droga pengojnë Shqipërinë drejt BE-së

Presidenti i Partisë Popullore Europiane (PPE), Josep Daul përmes dy shënimeve në rrjetin social "Twitter", shkroi dje se droga dhe krimi pengojnë rrugëtimin e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian. Numri një i popullorëve evropianë, grupim politik ky ku aderon edhe Partia Demokratike, thekson se Shqipëria duhet të plotësojë katër kushte për t'u marrë seriozisht në përpjekjet e saj për anëtarësim në BE. Daul renditë sundimin e ligjit, drejtësinë e pavarur si dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. "Aspirata e Shqipërisë për në BE do të merret seriozisht vetëm kur të sundojnë rregullat dhe ligji, drejtësia të jetë e pavarur si dhe të luftohet korrupsioni dhe krimi. Krimi dhe droga janë një problem i madh, që pengojnë rrugën e Shqipërisë drejt BE. Përpjekjet e vërteta duhet të bëhen për t'i luftuar këto krime me transparencë të plotë", thuhet në reagimin e Daul.



Komisioni i Sigurisë: Angazhim për zgjidhjen e problemeve në burje

Komisioni i Sigurisë Kombëtare shpreh angazhimin për t'u dhënë zgjidhje problemeve me të cilat përballen institucionet e dënimit penal. Anëtarët e Komisionit të Sigurisë kanë ndërmarrë një tur monitorues dhe dje ishin në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Arben Çuko e vlerësoi si mjaft të nevojshme ndërhyrjet për mirësi të ligjet bazë dhe kuadrin ligjor, që rregullon veprimtarinë e institucionit që drejton. Kryetarja e Komisionit për Sigurinë Kombëtare, Ermonela Felaj i kërkoi Çukos që t'i drejtojnë komisionit parlamentar një përmblidhje zyrtare të problematikave dhe sugjerimeve të institucionit që drejton, për të gjetur mundësitë e mbështetjes në rrugë parlamentare nga ana e komisionit.

"Arrestimi i Nanos nga Shane Korbeci në '98, Ruçi më çoi për ndjekje penale"

Berisha: Destabilitet, 9 mln euro drogë fshihen në tunelet shqiptare

"Lidhja e Gjicknurit dhe Ahmetajt me Habilajt"



Ish-kryeministri Sali Berisha deklaroi mbrëmë në "Studio e Hapur" në "News 24", se dosjen ku flitej për përfshirjen e Tahirrit e publikoi kryeministri Edi Rama. Ai u shpreh se ish-ministri ka pasur rolin e tij në bandën e drogës së udhëhequr nga Habilajt. Berisha akuzoi se ministri Xhafaj është i mbytur deri në fund nga dosja e vëllait të tij. Sipas tij, në Shqipëri gjenden plot 9 miliardë euro drogë e fshehur në tunele dhe magazina. Ai mohoi çdo lidhje farefisnie me tre prokurorët që bënë mbrojtjen e akuzës ndaj Tahirrit. Sipas tij, ka lidhje me ta, aq sa ka lidhje me bashkëshorten e ish-ministrit Saimir Tahiri që quhet Fatlinda Berisha dhe është nga Kosova. Për herë të parë z. Berisha zbardhi detaje lidhur me arrestimin e ish-liderit të socialistëve, Fatos Nano për trafik të lëngjeve të frutave në vitin '92, sipas tij nga ish-ministri i Tregtisë së Jashtme, Shane Korbeci dhe si e çoi Gramoz Ruçi për ndjekje penale në '98-ën.



Ish-kryeministri Sali Berisha

Saimir Tahiri është i përfshirë në trafik drogë. A e dini ju që ky parlament në 18 shtator të '98-ën i ka hequr imunitetin dhe dha vendim për ndjekje penale, pa e thirrur fare Sali Berishën. Ky parlament i dha vendim grupit. Gramoz Ruçi ka qenë. Nuk ka ndodhur kurrë kjo. Imaginoni ju që në vend të atyre prokurorëve, të cilët janë bazuar në një dosje të institucionit më të specializuar kundër mafies, vendosin të bëjnë diçka që nuk ishte bërë më parë dhe u përballën me sulm.

A mendoni se do ketë rrjedhje votash në radhë të mazhorancës për Tahirin, ose nga opozita?

Mazhoranca është tmer-rësisht e inkriminuar. Si mund të ketë rrjedhje votash, ku Damian Gjinkuri pret dosjen e tij. Arben Ahmetaj ka përgjeshtruar. Qytetari dixhital thotë që jo vetëm i njeh "Habilajt", por kanë sjellë edhe investitorë estonezë për biznes të përbashkët. E thotë populli shqiptar një fjalë: "Ku ka za s'është pa gja". Nuk jemi në drejtësi këtu, jemi në komunikim. Gjicknuri nesër do lëvizë me mace, me mi që të votojë kundër Ahmetajt është... nëse ka njeri që full e krye me gjithë çizme, që ka psikologjinë e blerjes është ai. Ai u bë dopio ministër, pagoi dopio. Mos prit gjë prej tyre. E ka bërë grupin ai. Si mund të presësh nga deputetët që vinë aty nga klanet e dragës?! Ata do të zbatojnë porositë.

Nëse kapet sistemi i drejtësisë...?

Unë e mbështeta Bashën që të hyjë në zgjedhje, se të mos hysh në zgjedhje do të thotë të çosh vendin në një konflikt civil, që unë nuk jam dakord. Nëse vdes drejtësia dhe merret në dorë nga një njeri që bën gjykatësin, prokurorin dhe kryeministren, këtu nuk ka zgjidhje tjetër përveç destabilizimit të vendit. Nëse vdes drejtësia, nuk mbetet gjë tjetër veç dhunës. Emiljano Shullazi rri me tre celularë në burg. Me njërin flet me Ramën. Ai komunikon me Ramën në telefon.

Për çfarë i duhet të komunikojë me Ramën?

I duhet me çdo kusht të dalë nga burgu.

Atëherë e kërcënon kryeministrin?

Pa diskutim e kërcënon. Po hyre në tratativa me ta...



PARALAJMËRIMI

Z. Berisha paralajmëroi se nëse kapet sistemi i drejtësisë nga kryeministri, atëherë vendi do të shkojë drejt dhunës dhe destabilizimit.



IMUNITETI

Ish-kryeministri Berisha tregoi se ishte Kuvendi, që vendosi në 18 shtator të '98-ës t'i hiqte atij imunitetin dhe ta çonte për ndjekje penale. Ish-lideri i PD-së tha se pas kësaj fshihej Gramoz Ruçi.

Z. Berisha, kryeministri Rama e konsideroi përpjekjen e prokurorisë për arrestimin e Tahirrit si ajo për Fatos Nanon, si e komentoni këtë?

Ka një ngjashmëri në kuptimin që dosjen e Fatos Nanos e përgatiti PS, e deklaroi këtu me përgjegjësi absolute, pa i shtuar goftë edhe një presje nga qeveria ime. Dosjen e Saimir Tahirit e përgatiti me një kompetencë të jashtëzakonshme institucionit më të specializuar në Europë për luftën kundër trafikëve, Antimafia italiane, por e bëri publike Edvin Kristaq Rama. Dosja italiane ka një rregull. Shtet mike para se ta plasim në erë, vijinë dhe të thonë që na ka dalë ky problem. Antimafia italiane është institucioni më i pavarur. Dikush nga ministria i ka thënë Ramës që kemi këtë problem. Unë di klanë që po festojnë për goditjen e Tahirrit. Rama dorëzoi dosjen për një zotim që kishte marrë, pra që ne nuk do pengojmë drejtësinë.

Pra, Rama e nisi me median dhe dosja u dha edhe opozitës, por jo nga Rama. Po në këtë linjë, ai nxori të parin Fatmir Xhafaj, që tha se hetimi italian nuk ka lidhje me ne. Ata i bënë të qartë që drejtësia do veprojë. Të mërkurën ishte një betejë e egër për të sabotuar që Tahirri të mos shkonte në emisionin "Opinion". Saimir Tahiri fakti në "Opinion"

banditin që foli me kodin e mafies, krye kombarja më ka lëshuar. Unë do të shkoj në burg, por do të bëj "Dantesin". Doli nga "Opinion" me Gaz Demin, i thuaj asaj për Edin që do të bëj publike 5 dosje, dosjen e Xibrakës, ku një nga emrat kryesorë është Olsi Rama.

Italianët e përgatitën dosjen kundër Nanos apo PS?

Do që t'i them me emra. Ish-ministri Shane Korbeci. Pse u bë kjo? Në atë kohë, Ramiz Alia krijoi një rivalitet absurd. Ministria e Jashtme e ndoqi problemin dhe e konstatoi këtë problem. PD nuk ka asnjë rol shtesë në atë dosje.

Po italianët?

Jo s'mund të them. Dosjen e përgatiti Shane Korbeci.

Çfarë roli ka pasur ish-ministri Tahiri në bandën e "Habilajt"?

Ai u kishte shitur targën dhe jo makinën Habilajve. Ai kishte vendosur postin e tij si transportues drogë. Po kështu ka qenë edhe skafi. Ai gjenjen, sepse ka shitur një skaf tek Habilajt. Të gjitha mjetet e transportit, ai i shiste tek Habilajt, si ka mundësi? Në këtë mision, Saimir Tahiri kishte detyrë që të mos u prisheshin plantacionet e Habilajve. Pse nuk u arrestua Balili? Balili ishte i fuqishëm, por Habilajt ishin më të fuqishëm se Balili.

Keni lidhje farefisnie me

AKUZA

Z. Berisha akuzoi ish-ministren e Mbrojtjes, Kodhelin, se deti ishte bërë 'autostradë e trafikantëve', pasi nuk funksiononte sistemi i radarëve. "E patë ju se kur iku Tahiri, fluturoi tre orë në zyrën e tij, për tri orë ngushëllime. Çfarë ngushëllimesh? Ata u takuan tri orë për të folur për dokumentet që kishin lejuar trafikun. Ja urdhëro, a është narko-shteti ky apo jo?", tha Berisha.



tre prokurorët që bënë mbrojtjen e akuzës ndaj ish-ministrit Saimir Tahiri në Këshillin e Mandateve dhe Rregullores?

Sali Berisha ka lidhje me tre prokurorët, aq sa ka lidhje me zonjën Tahiri që është nga Kosova. Zero lidhje! Ky është vetëm geni primitiv i krahinorizimit të Edi Ramës, ku si i mbytur kërkon të mbështetet. Asnjë lloj lidhjeje me ta,

përveçse janë nga Tropoja. Si e shoqja e Saimirit. Ky është Noriega. Noriega gjeti si pretekst se këta qenkan kushërinj të mi. Njëri kushëri i im, tjetri i djalit. Kam lidhje me ta, aq sa kam lidhje me bashkëshorten e ish-ministrit Saimir Tahiri, që quhet Fatlinda Berisha dhe është nga Kosova.

Operacioni në Babicë, ju publikuat i pari videon. Ka një akuzë se videon ua ka dhënë prokurori?

Absolutisht jo, nuk ma ka dhënë prokurori. Burimi është krejtësisht tjetër dhe jo prokuror. Është hera e parë që dëgjoj për atë prokuror. Ai ishte rezervati i Habilajve dhe u kapën 4 tonë, 20 mln euro. U shemb toka aty dhe tani na pengoi ky, na prishi operacionin.

A e dekonspiruat operacionin?

Atyre u plasi bomba në dorë. Ai ishte një operacion i organizuar nga shërbimi i fshehtë, që s'ka fuqi zbatuese, por prokuroria ka grupin e vet dhe mori dhe policinë.

I kishte denoncuar Xhafaj?

Emri i Xhafajit nuk ka si të mos ishte. Çfarë ishte ky njoftim, që thotë ky loloja, por vrapoj në Tiranë. Ishte koha e operacionit të "Fundit i marrëzisë", "Apex"-i i Xhafajit kundër të lotos së Habilajve. Ata erdhën tek Tahiri që "Apex"-i i Gon Xhafës po na asgjëson. Tahiri hyri dhe bëri zbutjen.

EPSA SHQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
 SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR :

- "Triall" me sip. 200 m² nga kjo ndrejtëse 114 m², Nr. pasurie 9/594, Vol. 27, Faqe 87, ZK 8532 i ndodhur në Sheq i Madh, Fier. Pasuria është hipotekuar në favor të Bankës Alpha sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi i është 54.400 Euro. Ankandi për do të zhvillohet datë 30.10.2017 ora 16.00 në adresën Rr."I. Qemalli", Pall."Fratri", K.6,Tirane.
- "Are" me sip. 9.159 m² Nr. pasurie 117/37, Vol. 10, Faqe 165, ZK 3981, i ndodhur në Sheq i Madh, Fier. Pasuria është hipotekuar në favor të Bankës Alpha sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi i është 58.400 Euro. Ankandi për do të zhvillohet datë 30.10.2017 ora 16.00 në adresën Rr."I. Qemalli", Pall."Fratri", K.6,Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni në tel. 04 2262711 ose në www.epsa.al.

EPSA SHQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
 SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR :

"Aparamenti" me sip. 237.15 m², Nr. Pas. 4/208+1-31, Vol.30, Fq.147, ZK 8514, e ndodhur në Durres. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Bankës Intesa SanPaolo Shqiptari sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 71.719 Euro. Ankandi do të zhvillohet datë 16.11.2017 ora 16.00 në adresën Rr."I. Qemalli", Pall."Fratri", K.6,Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni në tel. 04 2262711 ose në www.epsa.al

Zyra Permbartimore Kozeta Caka njofton shpalljen e ankandit të përfshirjen e "Pasurisë së Paluajtshme të llogaritë arë, me Nr. 101, të ndodhur në ZK 2947, vol 3, fq. 94, me sipërfaqe 400 m², Pëtrale, Tiranë", në pronësi të dëshitorit Ismail Gaja. Ankandi fillon me çmim fillësar 1.713.256 lëke. Ankandi do të zhvillohet në datë 07.11.2017, ditën e martë, ora 15:30 - 16:30, pranë Zyres Permbartimore Private Kozeta Caka në adresën: Bulvardi "Bajram Curri", Pallati "Palma e Artë", Kat 1, Nr. 22, Tirane. Të interesuarit të kontaktojnë në Tel: +355 44532280.

GRUPI I HABILAJVE

INTERVISTA

Ish-agjenti i antidrogës, Antonio Nazeraj: Na kërcënuan

"Si u largua me dhunë nga postblloku i policisë "Audi A8" i Habilajve"

Nazeraj: Na kërkuan ta hiqnin targën e mjetit nga raporti

Basir Çollaku

Z. Nazeraj, ju jeni një nga agjentët e antidrogës së Drejtorisë Fier prej shumë vitesh, por u arrestuat, dënuat, li-ruat, e më pas larguat nga vendi, çfarë ka ndodhur?

Unë kam punuar në Drejtorinë e Policisë Fier, për rreth tetë vjet, dhe pikërisht te zyra e antidrogës. Për tetë vjet kam qenë oficer i kësaj zyre, nga viti 2006 deri në korrik të vitit 2014, deri me 17 korrik kur dhe jam arrestuar.

C'ndodhi me ju, si nisi ngjarja që përfundoi me arrest?

Ne kemi pasur në muajt e parë të vitit 2014, një plan masash për kontrollë dhe postblloqe, kryesisht në autostradën Levan-Tepele-në, duke kryer çdo ditë shërbime, por ne oficerëve na binte që një herë në dy-tre ditë të ishim në postblloqe.

Ishte një plan i miratuar nga eprrorët tuaj?

Po, patjetër, ishte plan i miratuar. Po ishte hartuar nga drejtoria dhe në këto postblloqe dilte vetëm sektori kundër krimit të organizuar.

C'ndodhi gjatë këtyre shërbimeve, zoti Nazeraj?

Gjatë këtyre shërbimeve ka qëlluar një natë, kur ne ishim në shërbim bashkë me agjentët e sektorit kundër krimit të organizuar, sepse bënim, në fakt, dy tre postblloqe me oficerë të ndryshëm. Unë kam qenë në rrugë me dy agjentë dhe një polic të komisarariatit dhe kemi ndaluar një automjet, një "Audi" "A 8 AA003 GB".

Ku e ndaluat dhe cila ishte arsyeja e ndalimit?

Ne e kemi ndaluar në aksin rrugor Levan-Tepele-në, në afërsi të territorit, ku ndahej Mallakast-ra me Tepele-në. E ndalua këtë mjet në të cilin ishin dy persona **Arsyeja e ndalimit?** Arsyeja e ndalimit ishte kontroll i automjetit, sepse kishte dyshime për lëndë narkotike dhe kontroll të personave, të identitetit të tyre.

Dyshonit për këtë automjet?

Në përgjithësi, atje ne kishim dyshimet tona. Dhe e ndalua. Në momentin që e kemi ndaluar, nga sa kujtoj, kanë qenë dy vëllezërit Habilaj, dhe ka pasur debat me ta, sepse nuk kanë dashur të kontrollohen nga ana jonë, të bënim kontrollin e makinës, të identitetit të



Floria Habilaj

tyre, nuk pranoinin dhe patëm konflikt.

Ishte të shoqëruar apo vetëm?

Ishte të shoqëruar. Kanë insistuar që mjetit të tyre të mos u bëhej kontroll. Me sa kujtoj ishin të shoqëruar me dy femra. Në këtë moment duke debatuar kujtoj se na kanë kërcënuar, na kanë sharë dhe ofenduar dhe në ato momente, duke debatuar janë larguar nga pika e kontrollit, janë larguar me forcë.

Pa i lejuar ju?

Po, pa i lejuar ne janë larguar nga pika e kontrollit dhe më pas janë ndaluar dhe kontrolluar nga grupi tjetër, pasi u lajmëruan nga ana jonë.

Çfarë bëte më pas, i shoqëruat apo i latë të lirë?

Më pas ka vajtur edhe grupi ynë dhe janë shoqëruar për në komisarariat, automjetit dhe personat. Në komisarariat kanë qëndruar rreth 10 minuta apo 15 minuta dhe me urdhër të drejtorit të policisë në atë kohë, janë lënë të lirë. Unë dhe grupi mbërritëm pak më vonë në komisarariat dhe në atë moment u është dhënë urdhër që të dilnin nga komisarariat dhe të lireshin të lirë. Kur unë dhe kolegët e grupit tim kemi mbërritur në komisarariat, ky automjet dhe personat që ishin në të ishin në momentin e daljes nga drejtoria e policisë, duke ofenduar dhe kërcënuar punonjësit e policisë.

Çfarë kërcënimesh?

Kërcënime. Pasi këta e kanë shprehur edhe vetë se ishin njerëz

të ministrit, kushërinj të tij, ish-ministrit të Brendshëm, Sajmir Tahiri.


Konkretisht, cili ishte kërcënim i tyre?

Kërcënim i tyre, ishte se do ta shihni se çfarë do t'ju bëjmë. Do t'jua tregojmë shumë shpejt vendin se ku do të përfundoni, të gjithë ju që keni marrë pjesë në ndalimin dhe shoqërimin tonë.

Isht njohur më përpara me

Ish-agjenti i antidrogës në drejtorinë e policisë Fier, Antonio Nazeraj në një intervistë të dhënë për "Gazeta Shqiptare" tregon të gjitha detajet e ndalimit të Habilajve gjatë një kontrolli për drogë dhe historinë e gjatë që ndodhi pas raportit të bërë për shëfat e mëdhenj, ku iu kërkua korrektimi dhe hejja e targës së "Audit A 8" nga informacioni i dhënë.

precedentë penal që operonin në fushën e narkotikëve, që ishin të territorit të qarkut tonë, që bashkëpunonin me këta persona, në fushën e narkotikëve të trafikut në drejtim të Greqisë dhe Italisë, sipas dyshimeve dhe informacioneve tona. Dhe kemi përgatitur një informacion, së bashku ne, agjentët dhe shëfat, dhe kemi nisur një informacion të hollësishtëm në qendër, në Tiranë, për



Moisi Habilaj

kryerjen e veprimeve të mëtejshme me përgjim dhe metoda speciale të hetimit.

Çfarë ndodhi pas dërgimit të këtij informacioni?

Pasi dërguam këtë informacion, pas disa ditësh, më ka marrë shefi i sektorit në telefon dhe më ka sqaruar se këta numra kanë qenë të gjithë të fikur dhe na duhej të dërgonim disa numra të tjerë.

I dërguat?

Së bashku me shefin e sektorit dhe të tjerë, herën e parë dërguam mbi 7-8 numra, ndërsa herën e dytë disa numra dhe pritëm për ndonjë konfirmim për verifikim, por edhe këtë herë që-loi e kotë, numrat sërish dolën të padisponueshëm.

I dërgonit, sepse kërkoni ndihmë për t'i vënë në përgjim?

Arsyeja ishte sepse mendohej që nga zyra qendrore të bëhej edhe një bashkim procedimesh, por edhe për të parë verifikimin, nëse informacioni ishte i plotë dhe numrat ishin të disponueshëm.

Trafiku i drogës nuk ka nisur në 2013?

Jo, nuk ka nisur në atë kohë. Por informacion për këta ka pasur, sepse ne kontrollonim vetëm persona që ishin me gjendje civile në qarkun e Fierit...

Më keni thënë se kur dërguat informacionin për këtë persona drejtori ua ktheu për ta korrek-tuar, çfarë ishte kjo?

Po, informacioni kur është firmosur nga drejtori, na është kthyer mbrapsht për një verifikim të mëtejshëm, sepse kishte paqartësi **Kishte gabime ky informacioni?**

Ka pasur një tentativë për të hequr këtë automjet nga informacioni, këtë targë makine, një për-pjekje në mënyrë të fshehtë gjith-

ANTIDROGA

Ne kemi pasur informacion për këtë grup dhe një informacion, kemi përpiluar një material dhe e kemi nisur në zyrën qendrore në Tiranë për veprime të mëtejshme

këto emra, me këto persona?

Në fakt, ne jemi njohur me këtë grup të dyshuar kriminal në atë kohë, që operonte në fushën e narkotikëve, jemi njohur rreth muajit janar-shkurt 2014, nga zyra e Antidrogës Fier.

Isht gjithë zyra e Antidrogës e njohur me këtë informacion?

Ne kemi pasur informacion për këtë grup dhe një informacion, kemi përpiluar një material dhe e kemi nisur në zyrën qendrore në Tiranë për veprime të mëtejshme **Ku vepronte kryesisht ky grup?**

Ky grup operonte në Fier dhe Vlorë, pasi kishte dhe persona me

verifikime të mëtejshme. Informacioni përbëhet nga numra telefoni, nga targa makinash, autom-jetesh dhe emra personash.

E keni nënshkruar ju dhe eprrorët këtë informacion, që ia nisët qendrës?

Po, për këtë informacion është vënë në dijeni ish-drejtori i policisë Fier.

Ka gjurmë shpresore zyrtare ky informacion?

Po, ky informacion ka lënë gjurmë, sepse ka kaluar nga sekretar-ia, më pas është firmosur nga drejtori i qarkut dhe pastaj ka kaluar në zyrën qendrore në Tiranë, për të marrë dijeni, konfirmim dhe



monë.

Pa dijeninë tuaj?

Me dijeninë time. Mendonin se ishte e panevojshme përmendja e automjetit. Deri në atë moment unë nuk e dija se në emër të kujt ishte ky automjet. Sepse informacioni ynë, më së shumti, merrej në rrugë operative dhe konfidenciale dhe më pas përpunohej e dërgohej më lart.

Konfidencialisht nuk ju thanë përse donin ta bënin këtë?

Jo, mua personalisht, jo. Unë nuk e dija, sepse nuk kisha as akses për të bërë kontrollin në sistem se kujt i përkisnin targat e automjetit.

Dërguat dy herë informacione numra telefoni e të dhëna të tjera dhe u kthyen, çfarë ndodhi më pas?

Informacioni është kthyer mbrapsht dhe është arkivuar, sepse këto numra dolën të padisponueshëm dhe informacioni nuk ishte i saktë sipas zyrës qendrore.

Mund ta bënte dhe SHKB përgjimin?

Jo, zyra e SHKB nuk kishte akses të përgjonte grupe kriminale, ajo kontrollonte vetëm punën e policisë. Ne kemi qenë në dijeni pasi dërguam informacionin në Tiranë se ne ishim në përgjim non stop e gjithë zyra

Përse?

Këtë e dinë vetëm ata, por ne kur kemi dërguar këtë informacion, mësuam më vonë se ky ishte automjet në emër të ish-ministrit. Kemi qenë 24 orë në përgjim nga Shërbimi Kontrollit të Brendshëm dhe ishim të kontrolluar, ishte e vëzhguar çdo lëvizje që ne bënim, kishte ardhur dhe SHKB e Tiranës dhe gjithnjë ishim nën përgjim

Ju provokomin?

Ka ndodhur pas datës 3 maj kur është arrestuar shefi im i seksionit,

"Pas nisjes së raportit për këtë grup nisi përndjekja dhe nga shefat"

"Habilajt kishin mbështetje nga krerët e lartë të policisë, ne ishim të pambrojtur"

Ish-agjenti i antidrogës: Na arrestuan një pas një të gjithëve

it, Dritan Zagani, dhe dy agjentë të zyrës së Antidrogës dhe kështu ka vazhduar për rreth dy muaj me mua. Nga oficerët e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm që më telefononin disa herë dhe më linin takime. Pastaj më 4 maj 2014, më kanë transferuar me punë në komisaratin e Lushnjës dhe kështu kanë vazhduar në maje e në qershor, deri në datën 17 korrik 2014, datë në të cilën unë jam arrestuar.

Gjatë kësaj kohe?

Nga koha kur kemi dërguar këto informacione deri më 4 maj, kur me transferuan në Lushnjë dhe më ulën në detyrë, që ne ishim dhe gjithnjë në përgjim, dhe e çuditshme është se disa persona që ishin kontingjent dhe ishin të këtij grupi të strukturuar kriminal,

Cilit grup?

Grupit ku bënim pjesë edhe Habilajt, kemi qenë dy herë me shërbime në rrugën Levan-Tepelenë, se kemi pasur shërbime dhe në akse të tjera, rrugica, jo vetëm në rrugën nacionale, në autostradë, dhe për çudi disa nga këta persona gjenin edhe vendndodhjen tonë.

Si e gjenin vendndodhjen tuaj?

Ka pasur një rast në rrugën Fier-Tepelenë, në një restorant, ku kanë ardhur rreth 7 apo tetë veta me automjete fuoristrada, dhe kam qenë bashkë me shefin e sektorit dhe me disa agjentë dhe na ka paralajmëruar shefi i sektorit që të lëvizim të ikim dhe kemi dalë nga dera tjetër e restorantit

Ishit në operacion?

Ishim me shërbim dhe kemi marrë mjetet tona dhe jemi larguar nga aty...

U larguat ju dhe jo trafikantët...?

Gjatë bisedës me shefin e sektorit më ka thënë që një grup i strukturuar kriminal, që kishte mbështetje të fuqishme nga lart, na kishte vënë në shënjestër për të na eliminuar fizikisht.

Me mbështetje nga lart, si...?

Me mbështetje nga qeveria dhe nga ministri i Brendshëm në atë kohë...

Ju kishte vënë në shënjestër ju, oficerëve të antidrogës...?

Po, oficerëve dhe agjentëve të antidrogës, për të na eliminuar fizikisht, kjo ka qenë biseda që kam bërë me shefin e sektorit dhe na ka lajmëruar disa herë që, kur të shkonim në banesa të shmangim rrugicat, të shmangim errësirën, dhe gjatë gjithë kohës që ishim me shërbim të rrinim bashkë, dhe të mos ndaheshim nga njëri-tjetri, por të bënim kujdes, pasi ishim në rrezik për sigurinë tonë.

Kishte këto informacione dhe nuk kishit mundësi që këtë grup ta arrestonit e dërgonit në qeli...?

Këto sinjale ishin nga shefi i sektorit dhe i seksionit pasi ata



Antonio Nazeraj

kishin më shumë informacione se unë.

Nuk ndërhynt dot si strukturë antidroge?

Ne nuk ndërhynt dot për arsye se çdo gjë bëhej nga shefi i seksionit dhe sektorit dhe vazhdonim më lart, por pengohej hetimi apo shoqërimi këtyre personave këtij grupi të strukturuar kriminal, nga më lart, nga krerët të lartë të Policisë së Shtetit, ata kishin mbështetje nga krerët e lartë të Policisë së Shtetit dhe në ishim të pambrojtur, ishim në mëshirë të fatit dhe ishim të shkarë nga detyrat dhe gradat e ndjenim çdo ditë dhe çdo orë si brenda dhe jashtë komisarariatit në drejtorinë e policisë.

Mendonit se ka qenë ndikimi i tyre transferimi dhe arrestimi

Do rikthehem aty, por dhe një herë raportit me SHKB, a kishit presione e trysni?

PERGJIMET

zyra e SHKB nuk kishte akses të përgjonte grupe kriminale, ajo kontrollonte vetëm punën e policisë. Ne kemi qenë në dijeni pasi dërguam informacionin në Tiranë se ne ishim në përgjim non stop e gjithë zyra

Do rikthehem aty, por dhe një herë raportit me SHKB, a kishit presione e trysni?

Kur është arrestuar shefi i seksionit dhe dy agjentët e antidrogës dhe kur unë jam transferuar në Lushnjë, kam pasur telefonata nga oficerët e SHKB.

Kujtoni ndonjërin prej tyre?

Po, një nga oficerët ka qenë Berti, nuk e kujtoj të momentin mbisemrin, dhe më telefononte çdo dy ditë në komisaratin e Lushnjës dhe për këtë janë dëshmitarë edhe kolegët e mi në Lushnjë.

Çfarë kërkonte nga ju?

Unë nuk e kuptoja se çfarë kërkonte, por vinte e më takonte disa herë. Në një nga rastet më ka thënë se ka ardhur shefi i ri i SHKB këtu në Lushnjë dhe do ta

Ky grup kriminal?

Po. Nga informacionet që kemi pasur ne, po. Nga informacionet që kishim, kishin marrë në kontroll gjithë aktivitetin kriminal në fushën e narkotikëve edhe të drogave të rënda si heroina dhe kokaina.

mirë ta takosh ti nga afër dhe të merresh vesh. Një përpjekje për të sajuar prova dhe akuzat.

A ju kanë kërkuar para?

Po ka qenë një rast kur ai ishte plot me aparatura ishte me përgjues me vete dhe me fliste me shenja dhe me zë të mbytur, më thoshte që të pranoja faktin, se më duhen dymijë euro, në fillim më tha se duhen pesë mijë euro, ma bënte me shenjë me gishta, 5 euro, do vinë edhe ata të Tiranës. I them se nuk kam përse të jap asnjë lekë, sepse nuk kam bërë asnjë vepër penale. Dhe këtë e ka bërë shumë herë. Unë e shikoja se ishte gjithnjë me përgjues dhe kamera në trup, duke tentuar të më fusnin në grackën e tyre për një akuzë e fabul që kishin krijuar ata.

A kenit pasur kërcënime gjatë kësaj periudhe?

Kam pasur kërcënime nga Habilajt, në mënyrë indirekte për vete dhe për familjen, nga këta direkt, por edhe pjesëtarë të tjerë të bandës

Si ishin kërcënimet?

Kërcënimet ishin të tipit mafioz, që e ke kaluar vijën e kuge dhe me ty do të merremi në forma të tjera, m'i dërgonim me persona indirekt, me njohje pak a shumë të përbashkëta.

Dhe, ndonëse në një gjendje të tillë kanosjeje e tensioni, vijuat punën?

Po, vazhdova, madje në fund të prillit, kam pasur dhe biseda me shefin e sektorit, ku më ka sqaruar se ka një trysni ndaj teje nga ish-drejtori, trysni ndaj ish-shefit të sektorit.

Çfarë kërkonin nga ti?

I thoshin që këtë do ta largojmë nga puna, do ta fusim në burg, ishin biseda konfidenciale me shefin e sektorit.

Përse donin ta bënin këtë ndaj jush?

Me sa kuptoja unë, sepse mua më kanë marrë edhe nga qendra lart.

Kush të ka marrë dhe përse të kanë marrë?

Kisha tetë vjet në detyrë dhe s'më kishin marrë asnjëherë, por me merrnin me numra me 41, dhe më prezantoheshin si shefa të analizës, dhe më thoshin se nuk je shumë i aftë dhe i saktë për informacionet që përpilon.

Kjo pas dërgesës së këtyre informacioneve?

Po. Madje, në bisedë me shefin e sektorit më ka thënë që të largohem nga Shqipëria, pasi isha në rrezik për sigurinë time dhe të familjes, për të mirën tënde duhet të largohesh, pasi kam shumë informacioni e se je në rrezik, si nga grupet kriminale, ashtu edhe nga përfaqësues të Ministrisë së Brendshme...

(Vijon nesër)

PAKETA FISKALE NDRYSHIMET

Propozimi i DPTSHRR, taksat e reja për automjetet e luksit

Taksat e makinave, formula e re, ja sa do të paguani në 2018

Tarifa vjetore në bazë të cilindratës

Ornela Manjani

Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj ka bërë të ditur ndryshimet në paketën fiskale ku, përveç ndryshimit të taksës së pronës dhe përfshirjes në skemën e TVSH-së të 9 mijë bizneseve, do të përfshihet edhe ndryshimi i taksës së makinave. Duke nisur nga viti i ardhshëm, taksën e automjeteve të luksit do ta paguajnë edhe ata që kanë automjetet me kapacitet 6+1. Vendimi vjen si korrigjim i një parashikimi ligjor, që ka rezultuar se ka krijuar shteg për evazion fiskal.

Në ligjin ekzistues parashikohet se automjetet 4+1, që kanë cilindratë më të madhe se 3000 cm³ dhe një vlerë mbi 5 milion lekë, do t'i nënshtroheshin taksës. Por referuar relacionit të ligjit që vjen si pjesë e paketës fiskale, pronarët e automjeteve luksoze i modifikonin automjetet duke përdorur sediljet e vogla ose duke i shtuar ato (te fuoristradat) duke bërë që automjeti i tyre të figuronte si 6+1 dhe si rrjedhojë të mos prekej nga parashikimi ligjor. Një ndryshim i tillë, sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor, ka mundësuar që në 909 raste të bëhej një regjistrim i tillë, çka ka sjellë një dëm prej 19 milion lekësh për arken e shtetit.

"Ky propozim ka ardhur nga DPTSHRR në cilësinë e agjentit që mbledh taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze. Ky institucion ka përcjellë shqetësimin lidhur me kërkesën e pronarëve të mjeteve për të bërë ndryshim konstruktiv të mjeteve të cilët kanë cil-



FORMULA E TAKSËS

1. Taksa e mjeteve të përdorura të transportit (TVMP)
2. Taksë regjistrimi fillestar dhe taksë e përvitshme për automjetet luksoze (TVML)
3. Tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të cilat janë si me poshtë:
 - për leje drejtimi të kategorisë A 3.000 lekë;
 - për leje drejtimi të kategorisë B 4.500 lekë;
 - për leje drejtimi të kategorisë C 2.000 lekë;
 - për leje drejtimi të kategorisë D 3.000 lekë;
 - për leje drejtimi të kategorisë BE, CE dhe DE 3.000 lekë;

indratë më të madhe më të madhe se 3000 cm³; ose vlerën/cmimin të barabartë ose më shumë se 5 000 000 lekë, lidhur me numrin e vendeve duke kërkuar uljen nga 4+1 në 6+1. Kjo kërkesë bëhet me qëllim shmangien e kësaj takse. Sipas DPTSHRR, janë rreth 909 autovetura të regjistruara aktualisht me kapacitet 6+1, të cilat i janë nënshtruar modifikimeve për arsye të evitimit të kësaj takse. Efekti negativ në buxhetin e shtetit është 19.000.000 lekë nga mos taksimi i këtyre autom-

jeteve, të cilat duhet të konsiderohen makina luksi. Për këtë qëllim propozohet me anë të këtij ligji rritja e kapacitetit të vendeve nga 4+1 në 6+1, shkruhet në relacionin e nisjes së DPTSHRR.

TAKSA VJETORE

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm³ x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 12,5 lekë për naftën dhe

10 lekë për benzinën. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Pronari i mjetit, i cili nuk kry-

FORMULA E TAKSËS

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm³ x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 12,5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.



PROJEKTLIGJIT PËR TAKSAT E MAKINAVE

Ky projektligj synon të ndryshojë kriterin e kapacitetit fizik të automjeteve që konsiderohen automjete luksi për qëllime të këtij ligji. Aktualisht me ligjin në fuqi, konsiderohen automjete luksi, autoveturat deri në 4+1, të cilat plotësojnë të paktën një nga kriteret:

1. a) cilindratën të barabartë ose më të madhe se 3000 cm³; ose 2. b) vlerën/cmimin të barabartë ose më shumë se 5 000 000 lekë. Me ndryshimet e propozuara në këtë ligj, synohet që kriteri "4+1" të zëvendësohet me kriterin "6+1". Ky propozim ka ardhur nga DPTSHRR në cilësinë e agjentit që mbledh taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze. Ky institucion ka përcjellë shqetësimin lidhur me kërkesën e pronarëve të mjeteve për të bërë ndryshim konstruktiv të mjeteve, të cilët kanë cilindratë më të madhe më të madhe se 3000 cm³; ose vlerën/cmimin të barabartë ose më shumë se 5 000 000 lekë, lidhur me numrin e vendeve duke kërkuar uljen nga 4+1 në 6+1. Kjo kërkesë bëhet me qëllim shmangien e kësaj takse. Gjithashtu, propozohet riformulimi i nenit 11, germa "ç" të ligjit ekzistues. Neni 11, përcakton se cilat janë tarifat e shërbimit, sipas ligjit për taksat kombëtare, ku ndër të tjera germa "ç" parashikon se janë tarifa shërbimit, tarifat për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë. Nivellet minimale të tarifave të shërbimit, të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe agjentët tatimorë e komisionet përkatëse të tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe të titullarëve të institucioneve përkatëse.

en pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5 për qind të shumës së detyrimit të paguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit. 18 për qind e të ardhurave vjetore

nga kjo taksë i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 26.10.2017 ne orën 16.00 ne zyren e perbaruesit gjyqesor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajshme te llojit "Aparament" me siperfaqe 52.01 m², me volum 1, faqe 175, numer pasurise 1/214+2-15, ne zonen kadastrale 1664, me adrese Lagjia "Puntori", Pll.14, Shk.2, Kt.3, Ap.15, Fushë Kruje. Cimi ne ankand te pare eshte ne vleren 1.945.244,8 (nje milion e nenteqind e dyzet e pese mije e dyqind e dyzet e kater pike teke) lekë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 25.10.2017 ne orën 16.00 ne zyren e perbaruesit gjyqesor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajshme te llojit "Aparament" me sip.68 m², me nr.pasurie 2/166+1-5, ne zonen kadastrale 3682, me volum 2, faqe 54, i ndodhur ne Lagjia 11 Shtatori, pallati 9, shkalla 1, kati 2, apartamenti 5. Ure Vajgurore Berat. Cimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 1,568,000 (nje milion e peseqind e gjashtedhete e tete mije) lekë.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Perbaruesi gjyqesor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin per shitjen e pasurise se paluajshme "1x pjesë ideale taksose e dhelprit Hyson Mehmet Kaso, tek pasuria se paluajshme e lloji apartamenti, me numer pasurie 489-1-3, Volumi 11, Faqe 23 ne Zonen Kadastrale Nr.8130, me siperfaqe prej 78.94 m², e ndodhur ne Tirane, Adresa: Rr. Qemal Stafa, Shkalla 1, Kati 2, Ap.3", per shityerjen e detyrimit ne favor te kreditorit Redif Cepeli, per shumen 10 400 Usd dhe 139 742 lekë. Cimi fillestar me te cilin filloj ankandi eshte ne shumen 1480125 (nje milion e katërqind e tetëdhjetë mije e njeqind e njezete e pese) lekë, e përcaktuar ne raport vleresimitin e bere nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimim Nr. 5812 date 27.06.2017. Ankandi zhvillohet ne date 02.11.2017, ora 16.00 ne zyren e perbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, Rruga Abdi Toptani, Dendra Torro Drin, K12, Nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0684054605, email : ermirgodaj@zyraparbarimit.com

Drafti përfundimtar i Qeverisë për taksën mbi pasuritë

Trefishohet taksa e shtëpisë, fiksohet në 0.05% të vlerës

Bizneset do paguajnë 0.15% të vlerës së pronës



Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj

Ministria e Financave ka vendosur që taksa për ndërtesat të jetë 0.05% për qytetarët dhe 0.15% për bizneset. Drafti zyrtar i projektligjit "Për taksat vendore" që është pjesë e paketës fiskale 2018 përcakton pikërisht këto nivele. Siç ishte lajmëruar edhe më herët, baza e taksës nuk do të jetë më sipas modelit të vjetër, por në bazë të vlerës së ndërtesës. "Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Për efekt të amortizimit të pasurisë së paluajtshme-ndërtesa, Këshilli i Ministrave specifikon, gjithashtu, edhe nënkategoritë përkatëse. "Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë: 0.05% për ndërtesën ku taksapaguesi ka banimin e përhershëm ose zakonisht banon. 0.15% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari



Foto ilustruese

ekonomike", thuhet në draftin e qeverisë.

LLOGARITJA

Taksa e pronës për famil-

miht me atë që ka qenë taksa fikse, 400 lekë/m²,-tha ministri Ahmetaj. Pas taksës së pronës ndryshimi i dytë është ai që prek sektorin e turizmit, përkatësisht hotelet e reja me 5 vje. "TVSH 6 për qind për të gjitha hotelet që ndërtohen rrishtaz me 5 vje, që janë brand name, për të gjitha shërbimet brenda mureve të tyre",- bëri të ditur ministri. Këtë lehtësi e përfitojnë vetëm markat e hoteleve të listuara si brand name nga OKB. Paralelisht hotelet luksoze përfitojnë përjashtim nga tatimfitimi. "Për dhjetë vjet përjashtohen nga tatimfitimi",-tha ministri. Financat kanë gjykuar se taksa do të mblidhet përmes agjenti tatimor. Ky i fundit do të përfitojë 2% të të ardhurave të arkëtuara. "Detyrimi i taksës mbi ndërtesën sipas dispozitivave të këtij ligji mund të mblidhet nëpërmjet agjentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave dhe gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Agjenti i autorizuar përfiton 2% të të ardhurave të arkëtuara nga taksa e ndërtesave", thuhet në draft. Por ende mbetet për t'u parë se kush nga institucionet do të jetë agjenti. Gjasat janë që të jetë OSHEE, por kjo mbetet për t'u diskutuar.

Tërhiqet qeveria, shpëtojnë 21 mijë biznese

Bizneset me xhiro deri në 2 mln nuk përfshihen në TVSH

Qeveria është tërhequr pjesërisht nga shtrirja e TVSH-së tek i gjithë biznesi i vogël. Sipas Ahmetajt bizneset me xhiro deri në 2 milionë lekë, nuk do futen në skemën e TVSH, por do qëndrojnë kështu si janë. "Kjo do të thotë që përjashtohen ambulancat, tregjet e bashkive, zejtarët dhe, nëse sot janë gati 70 mijë biznese, që janë jashtë skemës së deklarimit të TVSH-së, gjithsej brenda skemës do të hyjnë vetëm 9 mijë. 61 mijë do të ngelen sërish të përjashtuar për shkak të nivelit të tyre të ulët të xhros nën 2 milionë",-tha Ahmetaj. Qeveria ka bërë publike për herë të parë edhe të shumëpërfolurën taksë për pronën. Sipas dispozitës së re ligjore, një familje, e cila ka një apartament me vlerë tregu 100 mijë euro, vitin e ardhshëm do të paguajë 50 euro taksë prone. "Duke ndryshuar metodologjinë e llogaritjes së kësaj takse nga një taksë fikse që bazohet në sipërfaqet e ndërtesës e shprehur në metër katrorë, në taksë në përqindje që aplikohet mbi vlerën e tregut të ndërtesës",-tha ministri



Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve

Rritet akciza për cigare

"Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë", bashkëlidhur ligjit nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nëndarja II "Duhan dhe nënproduktet e tij", kategoria T200 "Cigare që përmbajnë duhan", me kod nomenklature 24 02 20 dhe përshkrim "Cigare që përmbajnë duhan", shkalla e taksimit më 1 janar 2018 nga "... 5750 lekë/1000 copë" ndryshohet dhe bëhet "... 5850 lekë/1000 copë".

Ahmetaj. Për personat fizik dhe juridik, të cilët ushtrojnë aktivitet në prodhimin e software-ve, tatimi mbi fitimin është në masën 5%. Për qëllime të këtij ven-

dimi, Këshilli i Ministrave përcakton me vendim, aktivitetet që përfshihen në fushën e prodhimit të software-ve si dhe procedurat për zbatimin e këtij paragrafi.

Drafti



TAKSAT

"Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë: 0.05% për ndërtesën ku taksapaguesi ka banimin e përhershëm ose zakonisht banon. 0.15% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike", thuhet në draftin e qeverisë.

jet do të jetë 0.05 për qind e vlerës së pronës. Fillimisht ajo do të zbatohet vetëm mbi ndërtesat, më vonë do të shtrihet edhe tek truallit dhe

toka bujqësore. Për ndërtesat e biznesit taksa do të jetë tri herë më shumë. "Këtu sipërmarrja përfiton një lloj ulje të ngarkesës krahasi-



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të kondicionimit në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,604,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutjesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të kondicionimit në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 17 Nëntor 2017, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Prokuroria: Ngjarja e 8 janarit të vitit 2016, me një të vranë e 2 të plagosur, për hakmarrje

Atentati i Mbrostarit, prangoset në Kakavijë autori

28-vjeçari Ermal Binjaku u paraqit në doganë me identitet të rremë

GJIROKASTËR

Një 28-vjeçar nga Fieri është arrestuar në orët e para të mëngjesit të djeshëm në pikën kufitare të Kakavijes, pasi ishte shpallur në kërkim për vrasje. Bëhet fjalë për Ermal Binjaku, i cili akuzohet nga prokuroria si autori kryesor i atentatit të ndodhur më 8 janar të vitit 2016 në Mbrostar të Fierit, ku mbeti i vranë 44-vjeçari Denis Kasa dhe u plagosën 31-vjeçari Klement Kastrati dhe Elton Margariti. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Gjirokastrës bënë me dije se Binjaku u ndalua në hyrje të Republikës së Shqipërisë, në orën 00:47 të së martës. Mësohet se i riu ka deklaruar në doganën e Kakavijes gjeneralitete të tjera. "Shtetasi i mësipërm deklaroi gjeneralitetet të tjera (FB). Pas intervistimit dhe verifikimeve të bëra nga punonjësit e policisë në sistemin "TIMS", Ermal Binjaku rezultoi se është person në kërkim, pasi: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier me shkresë nr.444 datë 18.01.2016 ka dërguar urdhrin e ndalimit të datës 18.01.2016, si dhe ndryshim e veprës penale nga "Sigurimi kushteve për vrasje" në veprën penale "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese", thuhet në njoftimin e policisë.



Viktima e atentatit, Denis Kasa

ATENTATI NË MBROSTAR

Rreth orës 18:00 të datës 8 janar të vitit 2016, emigranti Denis Kasa ka qenë duke

udhëtuar me dy shokët e tij (Klement Kastratin dhe Elton Margaritin) për në drejtim të Lushnjës. Në vendin e quajtur "Kthesa e Mullirit të Artë" në fshatin Mbrostar, automjeti tip "Benz" që drejtohej nga 44-vjeçari Kasa ka ulur shpejtësinë, pasi rruga ishte me gropa dhe mungonte ndriçimi. Pikërisht në moment, persona ende të paidentifikuar (ishin pozicionuar mbi rrugë) kanë qëlluar me breshëri automatiku në drejtim të



Makina e djegur

"Benz"-it. Sipas bluve, drejtuesi i mjetit (Kasa) ka dalë me shpejtësi nga makina dhe ka tentuar që të largohet, por ka mbetur i vranë. Ndërkaq, janë plagosur rëndë dy shokët e tij, ndërsa mjeti është përfshirë nga flakët. Nga ana tjetër, atentatorët janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes me një makinë tip "Toyota" me targa të huaja, të cilën para se të kryenin vrasjen e kishin parkuar në anën e sipërme të rrugës. Nga

hetimet e kryera nga policia dhe prokuroria rezultoi se organizator dhe financues i vrasjes ishte Ermal Binjaku. Shkak i krimit, sipas prokurorisë ishte një konflikt i vjetër mes Binjakut dhe Kastratit. Sipas hetuesve të çështjes, Binjaku ishte vënë në dijeni se ndaj tij do të kryhej një atentat nga fisi Kastrati. Për këtë arsye, ai me ndihmën e Ylli Nazërajt, Ilir Memushajt dhe Florian Bushit përkatiti atentatin e Mbrostarit.

Në atë kohë, 33-vjeçari Bushi mbante detyrën e agjentit të SHISH, deri në 21 janar, ditën kur u prangos. Florian Bushi siguronte informacion për lëvizjen e Klement Kastratit, objektiv i sulmit, por që vetëm u plagos. Këto informacione i kalonin nëpërmjet telefonit Ilir Memushajt, i cili ia dërgonte më pas Ermal Binjakut. Ndërsa, Ylli Nezeraj kishte ndihmuar Ermal Binjakun dhe Ilir Memushajn.

HAKMARRJA

Po sipas burimeve të mësipërme, konflikti mes fiseve Binjaku dhe Kastrati kishte nisur në vitin 1994, kur i vranë mbeti kushëriri i Klement Kastratit dhe dyshimet ranë mbi vëllain e Ermal Binjakut. Në vitin 2000, një tjetër i afërm i Kastratit u vra në Fier. I dyshuar për këtë ngjarje ishte Ermal Binjaku. Ngjarjet kanë mbetur të pazbardhura nga policia. Pikërisht ky konflikt duket se është pasur nga atentati i Mbrostarit, që çoi në vrasjen e Denis Kasës dhe plagosjen e Klement Kastratit e Elton Margaritit.



European Bank
for Reconstruction and Development

JOB ADVERTISEMENT

European Bank for Reconstruction and Development
Tirana Resident Office

The EBRD seeks to recruit a **Receptionist** to be based in the **Tirana Resident Office**

The Receptionist is responsible for providing secretarial, clerical and administrative support to Resident Office (RO) staff in order to ensure an effective and efficient operation of the office. Acting as the first point of contact the Receptionist deals with general enquiries, answers phone calls and greets visitors as they arrive at the office. They also ensure that the office activities are running smoothly in terms of supplies and equipment and support the Resident Office staff with basic clerical duties and tasks.

Accountabilities & Responsibilities

RECEPTION

- Screening incoming telephone calls (internal and external), determine purpose of calls, and forward calls to appropriate personnel or department, take and deliver messages when appropriate personnel are unavailable;
- Answer questions about organization and provide callers with address, directions, and other information;
- Deal with general enquiries in a professional and courteous manner, in person, on the telephone or via e-mail; direct enquiries as appropriate;
- Greet and receive visitors, determine nature of business, direct and accompany visitors to appropriate personnel, keep visitors log;
- Assist visiting missions.

CLERICAL/ADMINISTRATIVE

- Arrange counters, screen, sort and process mail for RO staff;
- Scan, copy and send documents;
- Assist with maintaining the archives and filing;
- Schedule appointments for RO staff;
- Organize conference and meeting room bookings;
- Organize travel arrangements for the EBRD visitors on request;
- Provide assistance and secretarial back up to support bankers;
- Provide ad hoc support to the Office Manager;
- Responsible for the maintaining of staff whereabouts schedule;
- Responsible for checking general RO e-mail and forwarding to the relevant staff member for further action.

KNOWLEDGE, SKILLS, EXPERIENCE & QUALIFICATIONS

- Minimum secondary education, university preferred.
- Previous experience in a receptionist / secretarial capacity, preferably in international organisations;
- Excellent verbal communication skills with a good telephone manner;
- Good interpersonal skills;
- Computer literate, with keyboard skills and experience of word-processing, (Microsoft Word) and e-mail (Microsoft Outlook) combined with ability to acquire other skills as necessary;
- Ability to work on own initiative and take responsibility where necessary and to work as part of a team;
- Multilingual – excellent written and spoken English plus relevant country of operation language;
- Excellent organisational skills with ability to deal with people effectively.

Closing date: 29/10/2017

To apply for this position, please go to <https://jobs.ebrd.com/> requisition reference: 8261

Sekuestrohen 1 milion euro marijuanë në Itali, ja si u kapën duke ngrënë shegë 3 shqiptarët

ITALI - Policia italiane ka sekuestruar rreth 110 kg marijuanë dhe ka vënë në pranga 5 persona, mes tyre 3 shqiptarë gjatë operacionit të koduar "Cargo" të konkluduar pas muajsh hetime në Ferrara. Superngarkesa e drogës kishte mbërritur në një kabanon të braktisur në rrugën "Marconi", por ata që vëzhgonin gjithçka ishin njerëzit e skuadrës së lëvizshme të policisë. Ishte një kabanon në rrugën "Marconi" në Ferrara, baza e mbërritjes së ngarkesës mbi 100 kg marijuanë me një vlerë në treg prej më shumë se një milion euro.

Dërgesa vinte nga Spanja me destinacion tregun e Italisë së Veriut. Por, skuadra e lëvizshme e policisë, e koordinuar nga drejtuesi Andrea Crucianelli, që prej javësh po punonin për operacionin e koduar "Cargo", e dinin se do të mbërrinte një ngarkesë e madhe në qytet, e dinin se ku por nuk e dinin se kur, vetëm prisnin. Kështu për 20 ditë, policët shtrihen barakas duke monitoruar çdo ditë dhe çdo orë një kabanon të braktisur, edhe me ndihmën e një kamere survejimi. Derisa,



natën mes së dielës dhe së hënës, mbërrin kamioni që prisnin. Një mjet i tonazhit të rëndë që transportonte arka me fruta, mandarina, portokalle dhe shegë, si dhe 8 pako të mbyllura me nxehtësi që përmbanin më shumë se 110 kg marijuanë. Në timon ishte një transportues spanjoll, Joaqiun Martinez, 37 vjeç. Pranë tij një shtetas maroken, Nour Eddine Benazzi, 43 vjeç. Duke e pritur në brendësi tre burra me kombësi shqiptare: Vital Meço, 43 vjeç, banues në Cento; Tonin Bibaj, 33 vjeç dhe Alfred Gjoka, 36 vjeç, (në shtëpinë e tij u gjetën

gjithashtu 70 gr hashash), rezidentë në zonën e Savonës (Alasio dhe Andora). Të tre personat ishin filmuar nga kamerat e survejimit në vendin e ngjarjes dy ditë më herët në kabanon. Për të mbuluar ngarkesën "reale" ishte vendosur një mur me arka frutash. Një ndërhyrje rrufe që nuk i lë të tre trafikantët - që ishin duke folur dhe duke ngrënë shegë - kohë për të reaguar, dorëzohen menjëherë. Me ta janë 8 thasë plot marijuanë: me 10 euro për gram, do të sillte më shumë se një milion euro.

"Kathimerini": Vladimir Meçe, koka e grupit që trafikonte marijuanë nga Sarandë në Athinë

Arbër Sulo

GREQI

U arrestua në Greqi, "çobani" shqiptar: Ja si u përfshiva në trafikun e drogës

"U detyrova, më kërcënuan me jetë mua dhe familjen time"

U në jam çoban. Më kërcënuan me jetë mua dhe familjen time, ndaj u detyrova të transportoj një sasi hashashi nga Sajadha me destinacion Athinën". Kështu ka deklaruar gjatë marrjes në pyetje nga policia greke Vladimir Meçe, i njohur e pseudonimin "Laço" nga fshati Çiflig i Sarandës. 41-vjeçari, i cili konsiderohet nga autoritetet e vendit fqinj si "koka" e një grupi trafikantësh të linjës Sarandë-Athinë u arrestua në dhjetor të vitit që shkoi (kishte vetëm pak kohë që kishte dalë nga burgu) gjatë një operacioni që u zhvillua njëkohësisht në Igumenicë, Athinë, Axai dhe Aitiloakarnania nga policia greke. Gjatë këtij operacioni u sekuestruan në total 257 kg 845 gr marijuanë, 5730 euro, 100.200 lekë të reja shqiptare, 2 peshore, 35 fishekë, 25 celularë dhe 1 pre-re metalike. Në këtë operacion u arrestuan 11 shtetas, nga të cilët 7 grekë e 4 shqiptarë. Secili prej personave të kapur tashmë nga policia kishin funksionin e tyre në trafikimin e drogës nga Shqipëria në Greqi. Afro 8 muaj pas këtij operacioni (më 1 gusht të këtij viti) gazeta greke "Kathimerini" ka publikuar dëshminë e dhënë në polici të shqiptarit Vladimir Meçe. Në dëshminë e tij, Meçe ka deklaruar se e kërcënuan me jetë atë dhe familjen, ndaj dhe u përfshi në trafikun e lëndës narkotike. Ndërkohë, gazeta në fjalë bëri me dije se edhe të akuzuarit e tjerë e kanë justifikuar transportin e drogës për shkak të kërcënimeve apo problemeve ekonomike.

DËSHMIA E TRAFIKANTIT

"Jam familjar dhe banor i fshatit Çiflig në kufirin shqiptaro-grek, i punësuar si çoban. Kërcënonin jetën time, të gruas dhe fëmijës, ndaj u detyrova të transportoj një sasi hashashi nga Sa-



Vladimir Meçe



Droga e kapur në Greqi

jadha e Poshtme për në Sivota e pastaj në Athinë. U nisa me këmbë në orën 1 pas mesnate dhe për 40 minuta arrita në Sajadhe, ku më priste një gomone e kalbur. Për shkak të kushteve të vështira udhëtova 2.5-3 orë për të arritur në Sivota". 41-vjeçari shqiptar V.M. u arrestua mëngjesin e 14 dhjetorit të

vitit 2016, pak minuta pasi kishte shkarkuar në një plazh të Igumenicës 232 kg marijuanë. Drogën e morën 3 veta, të cilët me makina me qira do e çonin në Athinë, ndërkohë që një bashkëpunëtori i tyre, 37-vjeçari A.B., kishte detyrë të ndiqte lëvizjet e skafeve të policisë së Igumenicës. Me radhë ata u arrestuan në rrugën Rio-



Skafi i kapur në Greqi

KUSH ËSHTË VLADIMIR MEÇE

41-vjeçari Vladimir Meçe, i njohur me pseudonimin "Laço" kishte pak kohë që kishte dalë nga burgu në Greqi kur u kap në dhjetor të vitit 2016. Mësohet se në nëntor të vitit 2013, ai së bashku me dy persona të tjerë ishte kapur në Sajadhe, Igumenicë me një gomone me 374 kg marijuanë. Ndërkohë, në shkurt të vitit 2010, në stanin e tij në fshatin Çiflig të Sarandës u sekuestruan 240 kg marijuanë, por për këtë ngjarjeje u dënua vetëm babai i Vladimirit, Mehmet Meçe, në atë kohë 70-vjeç, me 4 muaj burg për "moskallëzim krimi".

Antirio nga policë të antidrogës së Athinës, të cilët dinin lëvizjet e tyre. Në një nga automjetet ata gjetën 79 kg marijuanë në 66 pako dhe në tjetrën 151 kg marijuanë në 261 pako. Në dosjen hetimore, Antidroga përshkruan si "kokë" të grupit 41-vjeçar V.M. dhe bashkëpunëtorë cilëson 10 persona të tjerë. Ata janë të paraburgosur dhe përballen me akuzat të rën-

da. Ndërkohë janë identifikuar, por i janë shmangur arrestimit 3 persona të tjerë. Bëhet fjalë për dy burra dhe një femër shqiptare, që njihet si "Ksenja". Ata u identifikuan përmes tabulateve telefonike. Njëri prej tyre madje, shqiptar, 28 vjeç, pranon i një lokalit natë në Greqi u ndalua më 24 korrik. Disa ditë para arrestimeve të para, ai kishte udhëtuar

bashkë me të tjerë për në Igumenicë, por pa u vërtetuar përfshirja direkte në trafik. Sipas policisë, më parë ishte anuluar trafikimi direkt i drogës nga Shqipëria në Greqi për shkak të defektit në motorin e skafit. 28-vjeçari pas marrjes në pyetje u la i lirë. "Nuk kishte prova", thanë avokatët e tij, Kostantinos Gogos dhe Agelos Kaguras. Të akuzuarit e tjerë e kanë justifikuar transportin e drogës për shkak të kërcënimeve apo problemeve ekonomike. "Kisha kompani transporti që nuk shkonte mirë. Së fundmi punoja 2-3 herë në javë në një karburant me rrogë mujore 180-200 euro. Në fillim të nëntorit më ofruan këtë punë si vëzhgues, me gjetjen në nevojë dhe më ofruan shpërblym 1500 euro", është shprehur një nga të akuzuarit.

ARRESTIMI

Vladimir Meçe u arrestua mëngjesin e 14 dhjetorit të vitit 2016, pak minuta pasi kishte shkarkuar në një plazh të Igumenicës 232 kg marijuanë. Drogën e morën 3 veta, të cilët me makina me qira do e çonin në Athinë, ndërkohë që një bashkëpunëtori i tyre, 37-vjeçari A.B., kishte detyrë të ndiqte lëvizjet e skafeve të policisë së Igumenicës.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivën e Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,388,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të rrihen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivën e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 16 Nëntor 2017, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



FORCIMI I POLICIMIT NË KOMUNITET NË SHQIPËRI



THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME

"Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri", program që financohet nga Qeveria Suedeze dhe që asiston zbatimin e reformës së policimit në komunitet në Shqipëri, shpall Thirrjen Nr.1 për Aplikime për Grante.

Organizata Jofitëprurëse (OJF), konsorciume dhe Organizata me Bazë Komunitare të cilët dëshirojnë të aplikojnë për grante nën Skemën e Grantëve të këtij Programi, janë të ftuar të paraqesin projekt-propozime të kuadrit të Thirrjes Nr.1, e cila do zbatohet në qarqet Durrës, Shkodër dhe Fier dhe do të qëndrojë e hapur nga data 23 Tetor deri në datën 19 Nëntor 2017, ora 17:00. Inkurajohen të aplikojnë organizata me seli në qarqet e mësipërme dhe projekt-propozimet të përfshijnë jo vetëm Bashkitë Qendër Garku (Durrës, Shkodër, Fier) por dhe në bashkitë e tjera (psh. Krujë, Malësi e Madhe, Lushnje, etj.), apo njësitë administrative përbërëse.

Për organizatat të cilat nuk kanë seli në këto qarqe, si kusht detyrues për aplikim në këtë thirrje, është bashkë-aplikimi me një organizatë lokale/aktivistë lokale duke nënshkruar paraprakisht një marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e projektit.

Programi do të ofrojë dy lloj grantesh:

- Grante deri në 15,000 € (2 për qarkun Shkodër, 1 për qarkun Durrës dhe 1 për qarkun Fier) do të jepen për projekt-propozime që synojnë a) fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile për të mbështetur krijimin dhe rritjen e kapaciteteve të koalicioneve me bazë komunitare me synim përmirësimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit e vazhdueshëm mes Policisë së Shtetit dhe komuniteteve vendore si dhe rritjen e besimit të ndërsjellë dhe; b) Përmirësimin e ndërvlerimit mes Policisë së Shtetit dhe aktorëve të tjerë lokalë, anëtarë të mekanizmeve lokale të referimit, për rritjen e cilësisë së masave parandaluese dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Përuroja e zbatimit të projektit: deri në 18 muaj
- Grante deri në 5,000 € (nga 2 grante për secilin qark) do të jepen për projekt-propozime që synojnë krijimin dhe konsolidimin e partneriteteve ndërmjet policisë, institucioneve vendore dhe komuniteteve duke pasur në fokus rininë, si iniciativa në fushën e bulzimit të konflikteve, ndërgjegjësimin, pasqortë e përdorimit të drogave dhe substancave narkotike, sigurinë në trafikun rugor, bulzimin dhe krimin kibernetik, trafikimin e qerive njëzore, krimet homologe, etj; me theks të veçantë në masat parandaluese. Përuroja e zbatimit të projektit: deri në 7 muaj

Projekt-propozimet duhet të plotësohen sipas Formularit të Aplikimit dhe Udhëzuesit për Aplikime që mund të shkarkohen nga linku <http://www.cp-project.al/web/grants> dhe do të dorëzohen elektronikisht në adresën grants@cp-project.al

Për më shumë detaje referohuni në: <http://www.cp-project.al/>

Prezantohet 'Guida Studentore' në universitete

Mazniku: 'Karta e Qytetit' për studentët, shërbime dhe çmime më të lira



Nenkryetari i Bashkisë së Tiranës, Arbjan Mazniku në Fakultetin e Shkencave Sociale

Me fillimin e vitit të ri akademik, Bashkia e Tiranës ka promovuar libërthin me informacione orientuese për studentët e sapoardhur në kryeqytet. Nenkryetari i Bashkisë së Tiranës, Arbjan Mazniku, gjatë një takimi në ambientet e Fakultetit të Shkencave Sociale theksoi se shumë shpejt studentët do të kenë mundësi të përdorin "Kartën e Qytetit", e cila përfshin edhe "Kartën e Studentit". Karta do të shfrytëzohet jo vetëm për linjat e transportit, por edhe për të përfutur shërbime të tjera me çmime

PERFITIMET

Shumë shpejt studentët do të kenë mundësi të përdorin "Kartën e Qytetit", e cila përfshin edhe "Kartën e Studentit". Karta do të shfrytëzohet jo vetëm për linjat e transportit, por edhe për të përfutur shërbime të tjera me çmime më të lira.

më të lira. "Një nga elementët kryesorë që do të kryejë kjo kartë është të shërbejë si një biletë permanente. Pra, do të kalojmë të gjitha linjat e autobusit në Tiranë, në linja që do të jenë

të pagueshme përmes një bilete elektronike. Do të përfundojmë procesin e biletimit elektronik, nga i cili do të prodhohet 'Kartat e Qytetit', që më pas do të përfshijë edhe 'Kartën e Studentit'.

Shërbimet që do të ofrohen me këtë kartë do jenë më të lira dhe të përcaktuara për studentët", tha Mazniku. Nenkryetari i bashkisë citoi gjithashtu se 'Guida Studentore' ndihmon studentët që të njihen me të gjitha aktivitetet apo shërbimet që ofron Tirana. "Kapitulli i parë flet për transportin publik, ndërsa pjesa e dytë ka të bëjë me akomodimin në qytet dhe procedurat për regjistrimin në rezidencat studentore; si funksionojnë, ku janë godinat, si funksionon struktura

e brendshme dhe çfarë shërbimesh ofrohen. Elementi i tretë ka disa informacione bazike për urgjencat mjekësore, zjarrfikëset, policinë etj.", tha ai. Çdo vit në qytetin e Tiranës fillojnë stu-

dimet mbi 10.000 studentë në programe të ndryshme studimi. Në lidhje me këtë, Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë një sërë nismash për ofrimin e shërbimeve për nxënësit dhe studentët.

Qendra e Zhvillimit Rezidencial, Durrës trajton 38 persona të moshës 7-26 vjeç

Fati i shtatë fëmijëve me aftësi të kufizuara, të braktisur nga familjet

Përgjegjësi: Birësimi, proces i vështirë

Voltiza Duro

Shumica e qytetarëve të Durrësit e dinë ku ndodhen vogëlushët e na orientojnë sesi të arrijmë deri aty. Nga larg dallohet një godinë e madhe e rrethuar me mure të lartë, vende-vende të plasarit, që ka në përgjegjësi fatin e 34 personave me aftësi të kufizuara, prej të cilëve dhe shumë fëmijë. Pasi shtymë derën e rëndë të hekurit me mbishkrimin "Qendra Zhvillimit Rezidencial Durrës", hymë brenda në kopsht, ku shikojmë vogëlushët që po afrohen shumë miqësisht. "Unë jam Romina, më pëlqen të pikuroj. Këtu në qendër kam bërë shumë pikura të bukura". - thotë vogëlushja duke buzëqeshur. Të braktisur nga prindërit e tyre, plot 7 fëmijë me aftësi të kufizuara të moshës 7-13 vjeç, trajtohen në Qendrën Kombëtare të Zhvillimit Rezidencial në qytetin e Durrësit. Sipas vendimit të gjykatës, këta vogëlushë janë shpallur "të braktisur" nga familjet, pasi për më shumë se një vit, asnjë nuk është kujtuar më për ta. I pyetur nga "Gazeta Shqiptare", përgjegjësi i sektorit social në këtë institucion tregon se dosjet e fëmijëve janë dërguar në Komunitetin e Birësimit. "Nuk kemi pasur asnjë shenjë interesimi nga prindërit dhe kështu në bashkëpunim me shoqatën amerikane "Bethany" kemi nisur procesin e birësimit për ta. Por, është e vështirë që të finalizohet ky proces për shkak të problematikave shëndetësore që ata mbartin. Aktualisht po bëhen përpjekje për të birësuar 13-vjeçarim me paralizë cerebrale në Amerikë, por nuk e dimë nëse do mund të realizohet apo jo", - shprehet përgjegjësi. Edhe një vit më parë, përfaqësuesit e kësaj



"Qendra Zhvillimit Rezidencial Durrës"



Punimet e fëmijëve të qendrës

qendre rezidenciale janë munduar që të birësojnë një prej fëmijëve, por sipas prindërve të interesuar për procesin e adoptimit, ky vogëlush nuk i plotësonte kërkesat që ata kërkonin, pasi ishte i sëmurë.

SHERBIMET

Janë gjithsej 34 persona me aftësi të kufizuara të moshës 7-26 vjeç që marrin përkujdesje në këtë qendër rezidenciale, kjo e fundit, në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. "Përveç 7 fëmijëve të braktisur, 27 të tjerë janë lënë nga vetë familjet në këtë institucion, për shkak të kushteve ekonomike apo rrethanave të tjera. Normal-

isht, ne po mundohemi t'u japim gjithë ngrohtësinë, kujdesin e dashurinë e nevojshme. Gjithmonë dëshirojmë që ata të ndihen sa më mirë në qendrën tonë, por roli i familjes në jetën e një fëmije është i pazëvendësueshëm", - tregon përgjegjësi. Ndërkaq, ai thotë se kategoritë që marrin shërbim janë individë me aftësi të veçanta të spektrit autizëm; ata me prapambetje mendore me parametra të lehtë, të mesëm, por edhe të rëndë; persona me sindromën Down si dhe ata me paralizë cerebrale. "Kjo është një qendër rezidenciale, pra këta individë me aftësi të

kufizuara jetojnë në ambientet e qendrës. Këtu ne iu ofrojmë çdo lloj trajtimi duke filluar nga strehimi, ushqimi, përkujdesja, trajtimi me medikamente dhe specialistë në bazë të diagnozave si dhe aktivitete edukative për t'i integruar në jetën sociale", - thotë përgjegjësi. Qëllimi i këtij institucioni është përmirësimi dhe aftësimi i këtyre fëmijëve në jetën sociale, si dhe rikthimi i tyre në familjet biologjike. Kjo qendër ka bashkëpunim edhe me shkollën sociale të qytetit, ku çdo ditë një pjesë e fëmijëve ndjekin programin arsimor edukativ të këtij institucio-

ni. Madje, përfaqësuesi i sektorit social në qendrën rezidenciale tregon se një prej fëmijëve me prapambetje mendore është nxënësi në një shkollë gjithëpërfshirëse dhe ka arritur të integrohet me së miri në jetën sociale e arsimore, normalisht i trajtuar me një program specifik. Gjithashtu, ai thekson se në qendër punohet me trajtime të specializuara dhe fizioterapisti dhe ortofonisti janë të trajnuar posaçërisht në fushën e aftësisë së kufizuar. "Pavarësisht problemeve dhe shqetësimeve që mund të kemi hasur në rrugën tonë, kemi arritur t'ia dalim dhe jemi përpjekur

që çdo gjë ta zgjidhim në mënyrën më të mirë të mundshme, ku shpesh edhe vullnetarët apo donatorët e ndryshëm na kanë ofruar ndihmë", - shprehet për "GSH përgjegjësi social.

AKTIVITETET

Qendra e Zhvillimit Rezidencial në Durrës realizon një sërë aktiviteteve për t'i argëtuar e për t'i integruar sa më mirë këta individë në jetën sociale. Çdo fëmije e të riu me aftësi të veçanta në këtë qendër i realizohet festa e ditëlindjes, ku marrin pjesë edhe animatorët të ndryshëm, çka i bën fëmijët që të këndojnë e të kërcëjnë së bashku. "Çdo të enjte, vullnetarët e një kishë që ne kemi arritur një bashkëpunim, vijnë dhe marrin fëmijët në karrige me rrota për t'i nxjerrë shëtitje, normalisht të shoqëruar edhe me pjesëtarë të stafit tonë. Ky është një lloj sensibilizimi edhe për opinionin publik, që duhet të reflektojë dhe të tregojë më tepër dashuri e ngrohtësi për fëmijët me nevojë të veçanta. Normalisht që për të rritur integrimin e tyre në jetën shoqërore, shpesh me ta kemi vizituar edhe Muzeun Arkeologjik, Amfiteatrin e madje edhe Kopshtin Zoologjik në Tiranë", - tregon përfaqësuesi i qendrës rezidenciale. Prej 3 vitesh, për t'u ofruar një mundësi në zhvillimin e aspektit profesional, 4 prej të rinjve të kësaj qendre janë përfutur të kurseve në Qendrën e Formimit Profesional.

VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 25 Tetor 2017 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Halimi dhe Çuçi "sherr" në emision: Sa i ke blerë syzet? Po ti orën?
- Ironia e Shkelzen Berishës për Tahirin: Trimin e ka Rama "çun"
- Jozefina Topalli i kthehet "rinisë", takon një grup miqsh
- Ministrja heq kostumin zyrtar dhe "merr" drejtimin e helikopterit

Djalë apo vajzë? Ja sesi mikesha i zbulon sekretin e fëmijës, Zaimina Vasjarit



LUANA VJOLLCA surprizon sërish, ja me kë do të drejtojë emisionin e ri



Ylli Maniani:

Rrëfimi i ish-ministrit, juristi në politikë që mbeti jurist



Politika për momentin nuk është punë, por qejf

Marrëdhënia me familjen dhe fillesat në PS me Fatos Nanon

Intervista

Rrëfimi i ish-ministrit, juristi në politikë që mbeti jurist

Ylli Manjani:

Politika për momentin nuk është punë, por qejf

Marrëdhënia me familjen dhe fillesat në PS me Fatos Nanon



Egla Xhemali

Në nga figurat më të njohura të politikës dhe avokatit në Shqipëri vjen në një rrëfim për suplementin "Vip Pages" të "Gazeta shqiptare". Bëhet fjalë për Ylli Manjanin. Rrugëtimi i tij në politikë ka nisur që në vitin 2002, kur i është bashkuar stafit të kryeministrit Fatos Nano e për të vazhduar më tej në PS deri në vitin 2010. Në vijim kontributi i tij ka qenë dhe është të LSI. Manjani na tregon se nëse do kishte mundësi të rizgjidhte profesionin, do ishte bërë mjek. Sa i përket pyetjes sa të bën të pasur politika, ai tregon se ka pasur dhe ka bindje të thellë se politikan është ai që i shërben publikut. Manjani bën politikë kritike në media dhe në rrjetet sociale. Sipas tij, vetëm bashkimi i forcave opozitare do jetë kyçi i suksesit opozitar. Manjani na tregon se ka mësuar politikën nga Fatos Nano, nga Rama ka mësuar elementet të aktrimit politik, ndërsa nga Meta ka mësuar durimin, por edhe guximin, kurajën e njëkohësisht nevojën për të mbajtur fjalën e dhënë. Ka mësuar edhe nga Berisha indirekt, nevojën për të bërë politikë me substancë. Sa u përket impenjimeve, Manjani pohon se puna e tij është avokatia, konsulentica ligjore. Përpos politikës, Ylli Manjani na tregon edhe për familjen e tij. Familja që ka ndërtuar me Evën është kryevepra e tyre. Për ata, rritja dhe edukimi i fëmijëve është një akt tolerancë. Momentin më të lumtur, ai quan ardhjen në jetë të dy djemve Redit dhe Tonit. I



pyetur nëse do të donte që ndonjëri nga djemtë të merrej me politikë, Manjani thotë se nuk do të donte që ata të bëheshin politikanë. Sidoqoftë, edhe nëse do të duan të këtë ta bëjnë vetëm pasi të bëhen më parë profesionistë. Nëse do t'i duhej t'a "braktiste" politikën, arsyeja e largimit nga çdo angazhim politik i tij do ishte për të qenë gjyqtar i shkallës së parë.

Si ka nisur karriera juaj në politikë?

Në vitin 2001 u njoha rastësisht me Fatos Nanon. Asokohe punoja në Prezençën e OSBE-së dhe për shkak të punës, kisha edhe kontakte me njerëz të politikës. Në këtë kontekst u njoha dhe zotin Nano. Në vitin 2002 u bashkova me stafin

e tij në Kryeministri dhe aty thellova njohjet e mia me njerëzit e politikës, por edhe me politikën. Zyrtarisht në një parti politike jam futur nga Edi Rama në vitin 2005. Kjo është shkurtimisht historia e fillimit të angazhimit tim me politikë. Në vijim kam kontribuar në PS deri ditën (viti 2010) kur Edi Rama nuk më thirri në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare si shenjë ndëshkimi për rreshtimin tim në grupin e Blushit. Në vijim kam kontribuar dhe ende kontribuoj në LSI.

Nëse do e ndalim kohën, cilin profesion do kishit dashur të zgjidhnit?

Nëse do të kisha mundësi të rizgjidhja profesionin, do isha bërë mjek. E kam dashur këtë profesion gjithmonë. Nëse do kisha mundësi

të zgjidhja punën që do kisha qejf të bëja si jurist, do kisha punuar me shumë qejf gjyqtar në shkallën e parë. Aty bëhet gjyqi. Aty dëgjon pjesë jetësh njerëzore. Aty jepet drejtësia e vërtetë. Më lart bëhet drejtësi sallonesh...

Të bën të pasur politika?

Ka njerëz që nëpërmjet politikës janë bërë të pasur, pa dyshim. Politika është kontakt me njerëz dhe me interesat e tyre. Politika administron interesa dhe shpesh nga kontakti me to, politikani përfiton. Këtu rrëmohet gjithnjë për të gjetur rrënjët e korrupsionit, por jo gjithmonë ndodh kështu. Politikani në radhë të parë është i detyruar të udhëhiqet nga interesi publik. Te fakti se sa afër këtij interesi është politikani, përcaktohet edhe votueshmëria e tij nga njerëzit. Për fat të keq, aktualisht në Shqipëri këto gjëra janë ngatërruar keq. Nuk merret më vesh se ku fillon e ku mbaron publikja e privatja tek politikanët. Sa më takon, kam pasur dhe kam bindje të thellë se politikan është ai që i shërben publikut. Për fat të keq, nëse shërbimi ndaj publikut nuk "shoqërohet" me ndonjë shërbim ndaj privatit, të bën të papranueshëm mjedisin e sotëm politik. Dhe që t'i vë kapak përgjigjes, nuk jam i pasur dhe as më ndihmoi politika të ndryshoj gjendjen pasurore. Bashkë me Evën kemi punuar gjithnjë në profesion dhe kemi jetuar e jetojmë mirë. Në disa raste përfshirja ime në politikë na ka ndëshkuar.


Çfarë opozite do shohim në parlament?

Opozitën parlamentare e përcjell edhe unë ashtu si ju nëpërmjet medias. Pra, nuk jam

aktor, por spektator. Unë vetë bëj politikë kritike në media dhe në rrjetet sociale. Megjithatë, kam një konstatim për opozitën dhe një për median. Partitë e opozitës po bëjnë opozitë sipas situatave që provokon qeveria. Deri diku kjo është normale, sepse është vetëm fillimi i legjislaturës. Opozitës nuk mund t'i kërkohet alternativë, sepse nuk është se qeveria vetë fitoi si alternativë. Ajo deshi tepsinë dhe emori. Çdo grupim apo individ që artikulon diçka politike pa dyshim që është më e mirë se tepsia. Sidoqoftë, bashkimi i forcave opozitare është kyç i suksesit opozitar. Tashmë opozita politike është bashkë dhe ky është lajm i mirë. Me gjithë projektet e Ramës për t'i mbajtur partitë e opozitës të përcara, ato janë votueshmëria e tij nga njerëzit. Për fat të keq, aktualisht në Shqipëri këto gjëra janë ngatërruar keq. Nuk merret më vesh se ku fillon e ku mbaron publikja e privatja tek politikanët. Sa më takon, kam pasur dhe kam bindje të thellë se politikan është ai që i shërben publikut. Për fat të keq, nëse shërbimi ndaj publikut nuk "shoqërohet" me ndonjë shërbim ndaj privatit, të bën të papranueshëm mjedisin e sotëm politik. Dhe që t'i vë kapak përgjigjes, nuk jam i pasur dhe as më ndihmoi politika të ndryshoj gjendjen pasurore. Bashkë me Evën kemi punuar gjithnjë në profesion dhe kemi jetuar e jetojmë mirë. Në disa raste përfshirja ime në politikë na ka ndëshkuar.

Çfarë opozite do shohim në parlament?


Opozitën parlamentare e përcjell edhe unë ashtu si ju nëpërmjet medias. Pra, nuk jam




Zaimina Vasjari do të bëhet me vajzë. Sekretin që këngëtarja e ruante prej kohësh ia ka zbuluar pa dashje në mikeshja e saj në "Facebook". Teksa ka postuar foto ku Zai shfaqet më në formë se kurrë, shoqja e ka uruar, duke zbuluar edhe gjininë. "Me dashuri ardh të princesha plotë jetë dhe shëndet", shkruan komenti. Kujtojmë se Zaimina që në fillim të shtatzënisë ka preferuar të mbajë gjithçka sekret, duke u shkëputur nga jeta publike. Vetëm ditët e fundit ajo ka ndarë me ndjekësit foto ku duket me barkun e rrumbullakosur. E teksa i afrohet fundit të pritjes, Zai duket më gati se kurrë për të qenë mamaja e një vogëlusheje.

Djalë apo vajzë? Ja sesi mikeshja i zbulon sekretin e fëmijës, Zaimina Vasjarit

LUANA VJOLLCA surprizon sërish, ja me kë do të drejtojë emisionin e ri



Një program i ri pritet të nisë këtë të shtunë në ekranin e "Top Chanel". Do të jetë pikërisht bukuroshja seksi, Luana Vjollca ajo që do të drejtojë formatin më të ri, "Kush Luan". Programi do të ketë në fokus argetimin, duke sjellë në ekran lojërat mes dy skuadrave me konkurrenca të fortë. Programi do të drejtohet, gjithashtu, nga dy personazhe të famshëm. Fati e do që Edi Manushi, drejtuesi i "Procesit Sportiv", të mos i ndahet familjes Vjollca. Pas përvojës si drejtues për thuasje një dekadë krah Marinës në të hënat e sportit, çdo të shtunë. Pritet që formati të sjellë një tjetër dimension të personazheve të famshëm, duke i bërë ata protagonistë të lojërave shumë të famshme, që më shumë sesa njohuritë vënë në test aftësinë për t'u përgjigjur i pari dhe saktë. Autorësia e "Kush Luan" i është besuar moderatorit të njohur radioteleviziv, Blendi Salaj.



Gjithmonë provokuese dhe shumë joshëse, bukuroshja sa herë që paraqitet në media. Se fundmi bukuroshja Gjoka ka postuar një fotografi në llogarinë e saj në "Instagram", në të cilën është shfaqur me bikini dhe fotos së publikuar komentet kanë qenë të shumta nga fansat dhe ndjekësit e saj, të cilët e adhurojnë par linjat e saj perfekte. Kristela hovin e famës e mori në kohën e martesës me këngëtarin kosovar Noga, me të cilin pas pak kohë u divorcua.

Provokon ish-bashkëshortja e Nogës, tregon të pasmet bombastike

etj... pra nuk i lodh e as i shtëllidhis qeveria, por opozita. Kjo vetëm në Shqipëri ndodh. Kjo tregon sesa rëndë është situata e mediave. Sidoqoftë, denoncimi i lidhjeve të qeverisë me krimin është një detyrë shumë e madhe dhe opozita po e bën shumë mirë. Nuk i kuptoj fare ata që artikulojnë "fajin e opozitës pse qeveria ka lidhje me krimin". Domethënë, i kuptoj fare mirë! Janë medinë gazetare, që i shërbejnë qeverisë.

Si janë raportet tuaja me kundërshtarët politikë? Për kë nga politikantët keni më shumë politikë?

Për mua, kundërshtar politik quhet çilido që ka një ide apo mendim ndryshe nga imi. Kudo qoftë ai/ajo. Pra, mbetet tek kundërshtia ideore dhe jonjerëzore. Kam mësuar politikën nga Fatos Nano. Ish-te universitet politik ai njeri. I shoqëruar nga vështirësi njerëzore, nga ai kam mësuar shumë nocione politike. Artikulimi i idesë, dialogu, toleranca por edhe vendimmarrja e konsultuar janë shkolla politike e Fatos Nanos. Ai fitoi simpatinë e njerëzve edhe për mesazhet e sofistikuar, por edhe të drejtpërdrejta. Në këtë kontekst, Nano ishte dhe mbetet universiteti i mendimit politik në Shqipëri. Nga Rama kam mësuar elementët të aktrimit politik. Substanca e politikës që Nano e kishte aset (më vonë mësova që edhe Berisha ishte politikan i substancës) humbet thuasje e tëra tek stili i Ramës. Duhet thënë se Rama ka qenë i suksesshëm me aktrim. Nga Meta kam mësuar durimin, por edhe guximin, kurajën e njëkohësisht nevojën për të mbajtur fjalën e dhënë. Kam më-

suar edhe nga Berisha indirekt, nevojën për të bërë politikë me substancë. Por jam ndarë (jo për gjithmonë) me të gjithë kur më është dashur të jem jurist. Të gjitha debatet e mia në mjedisin politik vijnë si reaguim për ligjshmërinë dhe konstitucionalizmin. Në këtë pikë nuk jam tërhequr asnjëherë. Jam larguar ose më kanë larguar, por jo tërhequr. Fakt është që politika del shumë shpesh mbi ligjin. Fakt është që Kushtetuta në Shqipëri është katandisur si letër që ndez zjarrin dhe jo si dokument serioz që shuan konflikte. Kjo gjë ka ardhur duke u përkeqësuar nga një kryeministër tek tjetri. Ndaj nuk jam pajtuar me asnjë në këtë këndvështrim.

A keni menduar ndonjëherë të largoheni nga Shqipëria?

Në situata të caktuara e kam

shprehur këtë gjë. Kthimi i partisë-shtet në krye të punëve nuk është një gjendje që sjell shpresë, me thënë të drejtën. Kishim menduar se partia-shtet ishte zhdukur nga realiteti politik, por mesa duket paskemi gabuar. Në kushtet e partisë-shtet gjërat bëhen natyrshëm të zymta. Ka vetëm një udhëheqës që qan e zgjidh hallet e popullit (në fakt, nuk zgjidh asgjë) dhe kjo është revoltuesja. Mirëpo vjen një moment që edhe revolta pushon dhe aty fillon e humbet shpresa. Ndaj njeriu kërkon të largohet. Pastaj kur bën pyetjen "ku", fillon përshatja... Mesa dëgjoj, kjo gjendje është tek shumë njerëz, përveç atyre që kanë dashur e duan të ikin sido të jetë situata politike këtu. Sidoqoftë, për momentin mendoj të punoj këtu në profesionin tim të avokatit dhe të merrem edhe poli-

tike ashtu siç di, duke menduar dhe u shprehur lirish. Angazhimet në parti në këtë moment i kam minimale, por në çdo rrethanë më ka pëlqyer dhe më pëlgen të mendoj si njeri i lirë. Por kur kam mandat përfaqësimi, veproj sipas rregullave të etikës së grupit.

Përveç politikës, cilat janë interesimet tuaja?

Ju thashë që puna ime është avokatia, konsulenca ligjore. Politika për momentin nuk është punë, por qejf.

Keni 20 vite që jetoni me bashkëshortin tuaj, Evën. Si ka qenë jeta juaj?

Kemi hyrë në fakt në vitin e 21-të të martesës. Mund të them se familja që kemi ndërtuar është kryevepra jonë. E kemi bërë me shumë dashuri dhe e mbajmë dhe e përmirësojmë me po të njëjtën dashuri. Jeta jonë ka qenë e rrethuar dhe ende është kështu, me miq e me shokë. Kemi punuar dhe ende punojmë jo pa stres, por me shumë dëshirë.

Cili është pasioni më i madh që keni?

Gjithçka lidhet me familjen. Rritja dhe edukimi i çunave na ka marrë shumë kohë. Jemi të dy natyra të forta, por edhe tolerantë.

Jeni babai i dy djemve. I toleroni apo jeni kërkues ndaj tyre?

Bashkë me Evën kemi mësuar se rritja dhe edukimi i fëmijëve është një akt tolerance. Por që toleranca të ndodhë duhet që më parë të ekzistojë argumenti i fortë e ndonjëherë edhe ndëshkimi. Pra, kjo punë është tërhiq e mos e këput (qesh). Sidoqoftë, Eva është bashkëbiseduesja e përminutshme me Redin dhe Tonin. Dhe e bën këtë gjë pa u lodhur.

Do donit që ndonjëri nga djemtë të ndiqte hapat tuaj drejt politikës?

Me thënë të drejtën, jo. Nuk do desha që çunat e mi të bëheshin politikanë. Natyrisht, ata janë rritur të lirë njaftueshëm për të marrë vendime për veten. Edhe tani që janë në shkollë, vendosin vetë. Ne përpigam të japim ndonjë këshillë "se duam, s'duam konsulentë jemi" (qesh) Sidoqoftë, edhe nëse do të duan të merren me politikë, do të desha që këtë ta bëjnë vetëm pasi të bëhen më parë profesionistë. Nuk bëhesh politikan pa shkollë e pa profesion. Është i gabuar modeli i politikanëve nga bankat e shkollës, më duhet ta pranohet këtë gjë. Politikani i mirë është profesionist dhe njeri i mirë. Dhe këto cilësi forcohen me kalimin e kohës.

Cila ka qenë dita juaj më e lumtur?

Pa dyshim kur Redi (1997) dhe Toni (2000) erdhën në jetë. Ata ishin kurorëzim i kryelumturisë që përjetuam kur Eva dhe unë u njohëm.

E keni menduar ndonjëherë shkëputjen nga politika? Nëse po, cila do të ishte arsyeja e "braktisjes" së saj?

Unë jua thashë se si e konceptoj marrjen me politikë. Mbetem në thelb një jurist jo tolerant dhe një njeri i lirë në shpirt, por aq sa korrekt në respektimin e detyrave përfaqësuese. Nga ana tjetër, nuk besoj se njeriu hyn e del në politikë. Çdoçkush merret me politikë edhe kur nuk hyn në parti. Të mendosh e të flasësh për politikë është detyrë qytetare. Por, do të kisha hequr dorë nga çdo angazhim politik për të qenë gjyqtar i shkallës së parë.



BULEVARDI

POLITIK



Halimi dhe Çuçi "sherr" në emision: Sa i ke blerë syzet? Po ti orën?

Ish-ministri, Bledi Çuçi dhe deputeti demokrat, Eduart Halimi kanë shkëmbyer replika të forta ndërsa kanë qenë duke debatuar për ngjarjet e aktualitetit. Çuçi dhe Halimi kaluan në akuzat personale gjatë debatit në "Top Story", ndërsa diskutonin për lidhje e ish-ministri Tahiri me trafikun e drogës. Përplasja ka përfunduar në sulme personale, kur Çuçi e pyeti Halimin se sa i kushtonte ora e tij e dorës, sepse i dukej e shtrenjtë. "As 200-250 euro, është markë Tissot... Ja, ta heq nga dora. Shihe markën!



Është Tissot, 200 euro. Po syzet e tua sa kushtojnë?" - iu përgjigj Halimi që nuk mori përgjigje nga Çuçi. Pas mbledhjes së Këshillit të Rregullorës, Mandateve dhe Imunitetit në media dhe portale u shfaq çmimi i syzeve Maybach të Tahirit që sipas referencave në internet i kalonte 10 mijë eurot.

Jozefina Topalli i kthehet "rinisë", takon një grup miqsh

Ish-deputetja e PD, Jozefina Topalli është takuar me një grup miqsh bashkëmoshatarë, të mbledhur si ish-gjimnazistë të gjimnazit Jordan Misja, në Shkodër, me të cilët ka bërë foto. Këtë e ka bërë të ditur Gasper Marku. "Rikthim shumë vite më parë. Me një pjesë të shoqeve dhe shokëve të gjimnazit "Jordan Misja", Shkodër. Mungojnë edhe shumë të tjerë, por një takim-përvjetor, më i plotë u premtua se do të organizohet vitin e ardhshëm. Lodoviku dhe Greta, "shpirti" i grupit e kanë marrë përsipër. Janë të lutur kolegët e tjerë jashtë vendit, të bëjnë me dije adresat e tyre dhe të konfirmojnë pjesëmarrjen. Deri atëherë, mirupafshim! Jetë të lumtur në familjet tuaja!,-shkruan Marku në faqen e tij në "Fb".



Ironia e Shkelzen Berishës për Tahirin: Trimin e ka Rama "çun"

Djali i ish-kryeministrit Sali Berisha, Shkelzeni ironizon qëndrimin e shefit të qeverisë ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Ky i fundit akuzohet nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për implikim dhe korrupsion pasiv në bandën e Habilajve dhe për këtë ka kërkuar autorizim për heqjen e imunitetit të deputetit. Shkelzeni ironizon duke e cilësuar Tahirin një "trim" që është i gatshëm të hetohet nga prokuroria, por pa iu hequr imuniteti. "Trimin rri e pret te dera e prokurorisë por me imunitet ama!,-shkruan Berisha, ndërsa duke iu përgjigjur një komenti, djali i ish-kryeministrit shkruan: E ka Rama "çun", duke nënkuptuar se kryeministri po e mbron.



Ministrja heq kostumin zyrtar dhe "merr" drejtimin e helikopterit

Olta Xhaçka është vlerësuar gjithmonë si një nga femrat më të bukura të politikës shqiptare. Ministren e re gjithmonë jemi mësuar ta shohim serioze, të veshur formale me xhakët dhe pantallona, por elegante. Por dje ministrja e PS-së postoi disa fotografi, ndërsa ka qenë për inspektim në Bazën Ajrore të Farkës. Ajo ka publikuar foto edhe brenda helikopterit të emergjencave civile. Siç e shihni edhe nga fotot, ajo duket shumë thjeshtë dhe bukur. "Në Bazën Ajrore të Farkës, pilotët dhe helikopterët e së cilës mbajnë një peshë të jashtëzakonshme në operacionet e kërkim-shpëtimit apo emergjencave civile",- shkruan ministrja në "Facebook".



BULEVARDI

POLITIK



Na merrni seriozis!..!



DHURATA

Botime të panjohura të albanologut Antonio Baldacci

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë pasurohet me tituj të rinj të albanologut të njohur italian, Antonio Baldacci. Drejtoresha e Institutit Italian të Kulturës, dr. Adriana Frisenna, me rastin e 150-vjetorit të lindjes së një nga personalitetet më të rëndësishme në fushën e albanologjisë, Antonio Baldacci, i ka dorëzuar të martën, më datë 24 tetor, drejtoreshës së Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë 22 njësi bibliotekare, disa prej tyre dokumente të panjohura nga publiku shqiptar. Tashmë studiuesit shqiptarë do të kenë mundësinë të thellojnë njohjen e tyre mbi studimet dhe kërkimet shkencore që albanologu Antonio Baldacci ka kryer gjatë punës së tij shumëvjeçare hulumtuese në Shqipëri.

Instituti Italian i Kulturës ka arritur të sigurojë nga biblioteka e Bolonjës publikimet e hershme të Antonio Baldacci-t, të cilat përfshijnë botime të viteve 1895-1948. Duke falënderuar, Frissenën, drejtoresha e BKSH, Persida Asllani u shpreh se "Këto materiale, të cilat pasurojnë edhe më tej fondet arkivore të albanologjisë në Bibliotekën Kombëtare, do të ndihmojnë në gjithë studiuesit të thellojnë informacionin mbi studimet e këtij albanologu të vyer". Ndërkohë, drejtoresha e Institutit Italian të Kulturës, Adriana Frisenna, duke shprehur vlerësimin e jashtëzakonshëm për albanologun italian theksoi "rëndësinë që ka për studiuesit e rinj që vepra studimore e albanologut italian të jetë sa më e plotë dhe Biblioteka Kombëtare, si qendër kërkimore shkencore, është institucioni i duhur në ruajtjen e kësaj arkive shkencore". Dhurimi i disa veprave dhe



Në foto: Persida Asllani dhe Adriana Frisenna

artikujve studimorë të Baldaccit për Shqipërinë, vjen si finalizim i misionit të Dr. Frisenna-s në krye të Institutit Italian të Kulturës.

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, përmes një ekspozite në ndër të 150-vjetorit të tij të lindjes, tha se synon jo vetëm të nderojë këtë albanolog të çmuar, por edhe të tërheqë vëmendjen e studiuesve të rinj mbi veprën e tij.

STUDIMET E BALDACCIT

Antonio Baldacci (1867-1950), botanist, gjeograf, i apasionuar pas studimeve etnografike, politike dhe social-ekonomike mund të konsiderohet edhe si albanologu me numrin më të madh të studimeve mbi Shqipërinë. Studimet dhe botimet e tij shkencore zënë një vend të rëndësishëm në fondin e botimeve albanologjike. Interesi i tij për Shqipërinë nisi më 1888, ndërkohë që vizita më 1902 në zonën kufitare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi konsiderohet edhe si misioni i parë shkencor italian



Në foto: Veprat e Baldaccit

imeti e tij shkencore zënë një vend të rëndësishëm në fondin e botimeve albanologjike. Interesi i tij për Shqipërinë nisi më 1888, ndërkohë që vizita më 1902 në zonën kufitare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi konsiderohet edhe si misioni i parë shkencor italian

Biblioteka Kombëtare pasurohet me 22 njësi dhuratë nga Italia



në këtë rajon. Gjatë ekspeditave të tij Baldacci ia doli të mblodhë mbi 100 mijë ekzemplarë bimësh, disa specie të panjohura më parë dhe që kanë marrë edhe emrin e tij. Puna e tij shkencore dhe publikimet e shumta në revistat më të zë kanë ndikuar edhe në njohjen e Shqipërisë. Janë rreth 250 monografi dhe artikujt shkencor që dëshmojnë veprimtarinë e tij të gjërë akademike. Në fondin albanologjik të Bibliotekës Kombëtare gjenden rreth 80 vepra studimore si: "Ricordi di un viaggio botanico

fra Prevesa e Janina" (1893); "Escursione botanica allo scolio di Saseno" (1893); "Rivista critica della collezione botanica : fatta nel 1892 in Albania" (1894); "Contributo alla conoscenza della flora dalmata, montenegrina, albanese, epirota e greca" (1894); artikujt e parë të veprës "Itinerari albanesi : 1892" botuar më 1896; "Crnagora : memorie di un botanico" (1897); "Escursione botanica nell'Albania" (1897); "Considerazioni preliminari sulla fitografia dell'Albania" (1898); "Gli Albanesi nel Montenegro" (1898); "Contributo alla conoscenza della flora del confine montenegrino-albanese" (1900); "Note statistiche sul vilayet di Scutari : la legge della magna Albanese" (1901); "L' Hinterland de L'Adriatique" (1904); "L' Italia nel Mediterraneo e nell'Adriatico" (1903); "L' Elemento latino nell'equilibrio balcanico" (1905); "Vallona e L'Acrocerania" (1913); "Il Nuovo Stato di Albania" (1913); "I Romeni dell' Albania" (1914); "Berat e il Tomor" (1914); "L' Albania" (1916); "Il Console napoleonico Pouqueville e il centenario della flora albanese" (1927); "L' Albania" (1929); "Studi speciali albanesi" (1932); "L' Orso bruno in Albania" (1933); etj.

Ndërkohë në gjuhën shqipe kanë ardhur tre nga veprat e tij më të rëndësishme "Rrugëtime shqiptare: 1892-1902" (2006); "Shqipëria e madhe" (2006), "Arumunët" (2010) si dhe "Tre udhëtime: te arumunët e Shqipërisë" (2011).

VITI I SKËNDERBEUT, AKADEMITË E SHKENCAVE ME PROTOKOLL BASHKËPUNIMI

Unëshkrua në Akademinë e Shkencave pro tokollit dyvjeçar i aktiviteteve shkencore (2018-2020), mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Protokollin u nënshkrua nga sekretarët shkencorë përkatës të Akademive: akademik Isuf Krasniqi (ASHAK) dhe akademik Vasil S. Tole (ASHSH). Një vend të veçantë në protokoll zënë aktivitetet për vitin 2018, shpallur si "Viti i Skënderbeut" nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë. Në të është mbajtur parasysh rëndësia e shkëmbimit të informacionit shkencor, si edhe ndërmarrja e nismave të përbashkëta shkencore nga të dyja palët, mbështetur marrëveshjes-kuadër ndërmjet dy akademive. Veprimtaritë e përbashkëta të dy institucioneve do të zhvillohen për ngjarje të ndryshme në dy vjet. Një konferencë shkencore ndërkombëtare mbahet në Tiranë në vitin 2018 për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, si figurë e shekujve të humanizmit evropian, ndërsa për 140-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, konferenca shkencore ndër akademikë mbahet në Prizren. 100-vjetori i Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", do përkujtohet me konferencë shkencore, në bashkëpunim me Institutin e Historisë, në Tiranë dhe Institutin e Historisë "Ali Hadri" të Prishtinës, në Shkodër; 2018, ndërsa 110-vjetori i Kongresit të Manastirit do të shënohet me konferencë shkencore ndër akademikë në Shkup e Manastir. Gjatë këtij dyvjeçari do të bëhet përgatitja për botim e akteve të veprimtarisë së Këshillit Ndërrakademik për Gjuhën Shqipe dhe vijim i punës së mëparshme Prishtinë, Tiranë 2018-2020, konferencë për romanin shqiptar që nga fillimi i shekullit XXI, konferencë për episte-



mologjinë e shkencave albanologjike sot, etj. Vëmendje i është kushtuar në këtë protokoll, edhe gjeoturizmit në hapësirën ndërkufitare malore - risi për zhvillimin ekonomik e kulturor në Shqipëri dhe Kosovë. Përparësi do të ketë, po ashtu, katalogimi online i fondeve albanologjike: bibliografite online të kërkuesve shkencorë; përirim dhe zgjerim i procesit të krijimit të sistemit bibliografik online të kërkuesve shkencorë shqiptarë; shkëmbim eksperience, përirim i bibliografive në proces; kualifikim i punonjësve të bibliotekave, profesionalizime mbi katalogimin e njësisve bibliografike; organizimi i panairit të përbashkët vjetor të librit akademik si edhe shkëmbimet reciproke të botimeve, të periodikëve dhe botimeve shkencore, ekspozita të botimeve të librit akademik. Sa i takon shkencën dhe kërkuesve të rinj protokollin parashikon veprimtari të përbashkëta të Akademisë së të Rinjve të Shqipërisë dhe kërkuesve të rinj në Kosovë dhe Tiranë, sikundër edhe veprimtari shkencore e përruruese në fushën e arteve.

LABORATORI I DIXHITALIZIMIT TE ARKIVI I SHTETIT KUSHTON SA INVESTIMET VJETORE

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave në bashkëpunim me TIKA (Agjencia Turke e Bashkëpunimit dhe Koordinimit) zhvilloi dje ceremoninë e përirimit të pajisjeve të dixhitalizimit për dokumentet osmane. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave Ardit Bido, Ambasadori i Republikës së Turqisë Hidayet Bayraktar dhe Koordinatorin i TIKA-s në Tiranë, Necip Ozay Ozutok. "Kjo marrëveshje bashkëpunimi me Arkivat e Perandorisë Osmane në Turqi dhe me ndihmën e TIKA-s, e cila mundësoi këtë laborator të ri dixhitalizimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave që do të mundësoi skanimin dhe dixhitalizimin të të gjithë dokumentacionit në gjuhën Osmane që gjenden në Arkivin Qendror Shtetëror si pjesë e bashkëpunimit që ne kemi me Arkivat Turke. Ky dokumentacion në kopjet dixhitale do të mbetet një kopje këtu dhe një kopje do të dorëzohet Arkivave Turke dhe Arkivat Turke do të dorëzojnë dokumentet që janë në interesin e Shqipërisë që gjenden në Arkivat e Perandorisë Osmane", tha drejtori Ardit Bido. Ai falënderoi TIKA-n për mundësimin e këtij laborator, i cili ka dhe një kosto të madhe aq sa gjithë fondi i investimeve që ka Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave për një vit, prandaj kjo risi tregon rëndësi për këtë partneritet. "Gjithashtu, falënderimi shkon dhe për ambasadorin Hidayet Bayraktar, i cili ka qenë përherë në krah të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave në projektet tona të përbashkëta, për të modernizuar kërkimin në Arkivat Shqiptare", shtoi Bido. Më tej, fjalën e mori ambasadori, i cili falënderoi Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe TIKA-n, ku cilësoi që bashkëpunimet do të vazhdojnë dhe në të ardhmen. "Ky bashkëpunim midis dy drejtorive është shumë i rëndësishëm, sepse ka vlerë që të gjitha këto gjëra do të kalohen dhe brezave të rinj. Është shumë e rëndësishme që historia të shkruset me gjëra sa më konkrete", - tha Bayraktar.



Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të

dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajo-

nale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikën e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e pjesës së njëzetë të listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikën që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka

marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkesin, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjistër janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe problematika

që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodër, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtitimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve kur subjekt

kërkon të përfitojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-ja. ATP-ja do t'i japë përparësi kompensimit të truallit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur.

LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E NJËZETË)

(Vijon nga numri i djeshëm)

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohi e M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Gjon e vellezer Serreqi		Guljem	Serreqi	74000 m2 toke bujqësore	Melgushe / 2644	211	6435	6435	ka vertetim ipotekor ka harte
Lucie	Sahatcia	Brigjida	Shestani	548 m2 toke truall	8593	125	548	548	ka vertetim ipotekor ka harte
Shuk	Serreqi	Guljem	Serreqi	5876 m2 toke bujqësore	Rranxa / 3205	66	5876	5876	ka vertetim ipotekor ka harte
Shuk	Serreqi	Guljem	Serreqi	5100 m2 toke bujqësore	Gur I Zi / 1989	221	5100		ka vertetim ipotekor ka harte
Menduh	Derguti	Hasan ; Shaqir	Dibra	pa siperfaqe	shkoder	256	Mbyllje procedimi		ka note transkripti
Mustaf	Kadia	Mustaf ; Isa	Kadia	magazine pa siperfaqe	shkoder	257	Mbyllje procedimi		nuk ka dokument ligjor nuk ka harta
Gege ; Rok	Marubi	Angjelina	Marubi	pa siperfaqe	shkoder	255	Mbyllje procedimi		ka vertetim hipotekor ka note transkripti
Selim	Mesi	Ali	Mesi	100 m2 dyqane dhe 616 m2 shtepi	shkoder	285	Mbyllje procedimi		ka vertetim pronesie ka harta
Vorf	Curaku	Pjeter	Curaku	pa siperfaqe	Fushe Arrez / 1656	35/1	Mbyllje procedimi		ka dokument kadastral
Frrrok	Frrroku	Çol	Frrroku	17000 m2 truall	Fushe Arrez / 1656	32/1	Mbyllje procedimi		ka dokument kadastral
Abdulla	Kazazi	Remzije	Kazazi	139 dy livadh, 197 dy toke bujqësore	Melgushe BerdiceV ukataneT rush , Mushan	109/1	Mbyllje procedimi		
Avdi	Shllaku	Avdi	Shllaku	20 ha kullote	Vukatane / 3838	128/1	Mbyllje procedimi		
Smajl	Elezi	Zenel	Elezi	110 dy are, 40 dy livadh	Fshati Kosmac, Komuna Bushat	141/1	Mbyllje procedimi		

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohi e M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Valentin	Kakariqi	Valentin	Kakariqi	e papercaktuar		136/1			Mbyllje procedimi
Ded	Deda	Liljana	Muzhani	1.8 ha livadh	Fshati Shtoj / 3428	122/1			Mbyllje procedimi
Nush	Mistocia	Meri	Curani	sip. e papercaktuar, kullote, toke are	Fshati Shtoj / 3428	124/1			Mbyllje procedimi
Kol ; Lec	Suma	Agetina	(Pistulli)	12 dy toke are	lagja Perash Bashkia Shkoder	236			Mbyllje procedimi
Anton	Dukagjini	Leke	Dukagjini	sip. e papercaktuar, are, truall, kullote, livadh	Iballe / 1976	355			Mbyllje procedimi
Vlash	Topallaj	Pashuk	Topallaj	147.4 ha toke bujqësore	Trush / 3652				Vendimi nuk ka Rubriken e titullit ekzekutiv
Ndoc	Ndoka	Prek	Molla	58 dy toke byjqësore	Baks-Rrjoll / 1076				Vendimi nuk ka Rubriken e titullit ekzekutiv
Ndoc	Ndoka	Prek	Molla	61.600 m pyll	Baks-Rrjoll / 1076				Vendimi nuk ka Rubriken e titullit ekzekutiv
Jakup	Lezha	Ylvije	Lezha	1056 m truall	Lagja Skenderbeg Bashkia Shkoder	275			Mbyllje procedimi
Palok	Nika	Zef	Deda	76 500 m toke bujqësore	Pulaj / 3072				Vendimi nuk ka Rubriken e titullit ekzekutiv
Marash	Malaj	Marash	Malaj	110 dy toke bujqësore	Ivanaj / 1989	77/1			Mbyllje procedimi
Qemal	Muhaj	Qemal	Muhaj	1 750 m Truall	Puke / 3069	356			Mbyllje procedimi

Fatime	Pirenej	Zaim	Pirenej	Ritrajtim i vendimit të KKKP Bashkia Shkoder	Bashkia Shkoder			1. Me Vendimin nr. 1275, dt. 26.09.1996 të KKKP Bashkia Shkoder l eshte njohur dhe kthyer subjektit sip ne total 11 400 m truall. Sub l eshte drejtuar AKKP per rregullimi ne plnvendo sjes se ketij vendimi 2.) Vendimi l AKKP-se												
Tahir ; Bajram	Hoxhaj	Shefik	Hoxhaj	1 250 m kullote	Fshati Rrepush, Komuna Shkrel	56/1		Mbyllje procedimi												
Pjeter	Malaj	Pjeter	Malaj	10 400 m toke bujqesore	Bajze / 3982	85/1		Mbyllje procedimi												
Bajram	Gusiqi	Sadete	Rexha	2508 m livadh		8591			Vendimi nuk ka Rubriken e titullit ekzekutiv											
Halil	Vasija	Shkelqim	Vasija	5.55 dy	Lagj.Pera sh Bashkia Shkoder				Vendimi nuk ka Rubriken e titullit ekzekutiv											
Halil	Vasija	Shkelqim	Vasija	53 m truall	8597 Bashkia Shkoder				Vendimi nuk ka Rubriken e titullit ekzekutiv											
Halil	Vasija	Shkelqim	Vasija	120 m truall		8591			Vendimi nuk ka Rubriken e titullit ekzekutiv											
Asilan	Boriçi	Fridos	Boriçi	13 350 m truall	Gril / 1864	60/1		Mbyllje procedimi												
Tome	Kola	Pashk	Kola	7 570 m toke are	Qafe Mali, Fushe Arrez / 3074	37/1		Mbyllje procedimi												
Abdulla	Gania	Basri	Asllanaj	4 070 m Truall	Lagj. Zotni,	39/1		Mbyllje procedimi												
Zade	Gruda	Asim	Gruda	16 900 m truall	Lagj Rus, Kongresi l Permetit Shkoder/		239	Mbyllje procedimi												
Tef	Gjinaj	Pjeter	Gjinaj	126 dy			251	Mbyllje procedimi												
Zef	Suma	Nikolin	Lushi	12 e 1/ dy toke are, 12 dy livadh, 92 dy korije	Dragoç, Bardhaj, Kuç,Rrenc , Ana Malit	135/1		Mbyllje procedimi												
Mara	Prela	Dede	Kaci	44 dy livadh	Velipoje / 3734	123/1		Mbyllje procedimi												
Pashko	Ivanaj	Simon	Ivanaj	42.5 dy toke are e truall	Fshati Vrith / 3834		69/1	Mbyllje procedimi												
Zef	Gjoni	Jak	Gjonaj	sip. Papercaktuar, 1 shtepi, 2 dyqane	Bashkia Shkoder		234	Mbyllje procedimi												
Nadir	Jakupi (Zagani)	Nimet	Zagani	30 dy livadh, 135 dy toke are	Shkjeze / 3389	155/1		Mbyllje procedimi												
Tush	Krasniqi	Kol	Kakarriqi	15 dy toke are	Berdice / 1157	131/1		Mbyllje procedimi												
Oso	Saraçi	Fadil	Saraçi	16 dy Toke are, 33 dy livadhe	Vukatane, Rrushkull, Suka	115/1		Mbyllje procedimi												
Dom	Shllaku	Klaudia	Gargiola	70 dy are, 14 dy livadhe	Obot / 2819	114/1		Mbyllje procedimi												
Sadik	Avdia	Avdi	Zagni	50 dy are, 15 dy livadhe	Shkjeze / 3389		154	Mbyllje procedimi												
Shaban	Haxhia	Jaho	Haxhia	1 000 m kullose	Puke / 3069	27/1		Mbyllje procedimi												
Prend	Guri	Dila	Ndreu	Toke+ shtepi, sip. e papercaktuar	Fshati Levrushk / 2439	31/1		Mbyllje procedimi												
Llesh	Prela	Prend	Prela	2 325 m truall	Fshati Spaç / 3261	36/1		Mbyllje procedimi												
Xhamija Shtoj i Ri		Musa	Ademi	7 400 m truall	Shtoj i Ri / 3428		369	Mbyllje procedimi												Me Urdherin nr.2910/6 ,dt. 5.2.2010 të D.Pergj. Eshte urdheruar mosushtri m iniciative ndaj vendimit te qarkut. .
Vehbi	Çanga	Agron	Kelmendi		Ndreqe pasaktesi e te v. 227, dt. 26.5.1994				388	Ndreqe gabimi dhe pasaktesi e te vendimit nr. 227, dt. 26.05.1994 te KKKP.										ka lidhje me dosjen 730 dt. 22.10.1993
Nurije	Hysa	Nurije	Hysa	3 dy livadh, 3 e 1/ are		8592	291	Mbyllje procedimi												
Faik	Hardolli	Nazmije	Hardolli	410 m truall		8591	439	Mbyllje procedimi												Si pjese integrale e vendimit nr 439, eshte nxjerre urdheri nr. 381/5 dt. 22.03.2010 l D. te Pergj te AKKP, per mosushtri m iniciative , e qe zevendes on plotesimi n e rubrikesti tull ekzekutiv.
Trashegimtaret	Saraçi	Arben	Kopliku	12 dy toke are	Lagja Sektori II		271	Mbyllje procedimi												

(Vijon nesër)

Opinion i Ditës

Vazhdimësi apo ndryshim në Kinë

Nga doc. dr Vasil Kureta

(Vijon nga faqja e parë)

... politik e ekonomik që Kina ka, zhvillimi i kongresit të 19 të PKK, është ndjekur me interes të veçantë, për të kuptuar më shumë rreth zhvillimeve të ardhshme, por sidomos për të kuptuar më shumë rreth pyetjes, nëse do të ketë një vazhdimësi në ecurinë e Kinës apo do të përjetohet një ndryshim konkret, por dhe për të kuptuar më shumë edhe për pushtetin konkret të Xi Ping dhe vizionin e tij për të ardhmen e Kinës. Interesimi është rritur sidomos edhe nga deklarimi në këtë kongres apo paralajmërimi i Xi Ping, për ndryshime të thella e të komplikuara në Kinë dhe në botë, si dhe për mesazhin e përcjellë nga ky event politik, për një Kinë moderne e të hapur me botën.

Ajo që lexohet qartë është se, Kina ka marrë vendime konkrete për të avancuar më tej strategjinë e saj të superfuqisë botërore, të nisur me të njohurën "politika e katër modernizimeve", që nga koha e Mao Ce Dun e Ten Hsiao Pin. Këtë domethënie ka deklarimi për një Kinë moderne e të hapur me botën. Megjithatë, politika kineze është po aq e lexueshme sa dhe e palexueshme, për të kuptuar përtej deklarimeve konkrete, apo për të mësuar ecurinë e ndryshimeve të saj në atë rrugë që Xi Ping e quan modernizim. Modeli politik e ekonomik i Kinës ka brenda disa linja e balanca, që çdo njësh politik nuk mund t'i dekonsiderojë apo t'i ndryshojë lehtësisht.

Kongresi dëshmoi peshën dhe pushtetin e PKK në modelin politik ekonomik të Kinës, që do të thotë se Kina do të vazhdojë të mbajë tabelat komuniste në bashkëjetesë me reformat modernizuese dhe që Xi Ping do të jetë lideri më i fuqishëm në vendimmarrjen në Kinë. Megjithatë, pyetja e ligjshme që shtrohet është, se nëse ka lindur apo do të lindë e fuqizohet më tej një gjeneratë e re në Kinë, që vërtet e dëshiron modernizimin kompleks të Kinës dhe të modelit politik e ekonomik të saj, modernizimin real të ngritur mbi sistemin e vlerave të shoqërisë kineze. Ka shumë faktorë që ndikojnë në këtë drejtim e pyetje që kërkojnë përgjigje. E një rëndësie të veçantë është se si do harmonizohen edhe roli i PKK edhe modernizimi i shoqërisë kineze. Por nga këndi i modernizimit të Kinës, modeli aktual i Kinës me tabelat komuniste dhe rolin e PKK, mënyra e qeverisjes dhe e funksionimit të institucioneve shtetërore e politike, kuptohet se ky model ekletik nuk mund t'i qëndrojë dot procesit real të modernizimit, apo që ndryshimi bëhet i pashmangshëm. Në këto kushte, duke mos përjashtuar përvojën e konceptet historike të qeverisjes së Kinës, duke marrë në konsideratë përmasat e mëdha ekonomike, demografike e madhësinë territoriale, pra duke nënkuptuar veçoritë konkrete që do të marrë modeli politiko-ekonomik i Kinës, ai do të përfshijë elemente thelbësore që i kërkon modernizimi dhe



për rrjedhojë sistemi i vlerave, funksionimi i institucioneve demokratike, shteti juridik e sundimi i ligjit etj. Ndryshe modernizimi nuk mund të kuptohet e mbetet një deklaratë e bukur, pa vlerë reale.

Që nga përgatitja e programit të katër modernizimeve dhe vizitës së parë të presidentit amerikan Nikson në Kinë, që u vlerësua si çarja e madhe në botën komuniste, Kina ka ecur ngadalë, por e sigurt në rrugën e ndryshimit e modernizimit, me synimin e pandryshuar të sigurimit të statusit të superfuqisë botërore. Ajo, në këtë rrugë, ka sot

ekonominë e dytë më të madhe në botë, që ka prirje të bëhet dhe ekonomia e parë, që ka një rritje ekonomike relativisht të lartë e të qëndrueshme dhe, që përballoi me sukses dallë të mëdha të krizës botërore e financiare të shpërthyer në vitin 2008. Perëndimi ka vlerësuar e mbështetur këtë ndryshim, me koncepte, metoda e veçori kineze, që nuk është ndërprerë, por edhe rolin e drejtuesve kryesorë kinezë, përfshi dhe Xi Ping, ka forcuar bashkëpunimin e dialogun.

Tash duket se Kina ka mbërritur në një stad të avancuar për të

bërë realisht një ndryshim cilësor të modelit politik, ekonomik e social të saj, në të mirë të popullit kinez e të zhvillimeve botërore. Dhe Xi Ping ka përcaktuar qartë detyrën kryesore në këtë formë të kuptueshme: përpjekje për të krijuar mirëqenie në Kinë dhe që të bëjmë socializmin e tipit kinez të suksesshëm "për një epokë të re". Sipas tij shanset janë të mira, por sfidat janë serioze. Kina dhe bota ndodhen përballë ndryshimeve të thella e të ndërlikuara. Ai e ka të qartë nivelin e ulët të mirëqenies, prandaj dhe e vuri theksin te lufta kundër varfërisë dhe pabarazisë.

Këtë synim themelor e lidhi edhe me një luftë të vendosur kundër korrupsionit, teksa evidentoi parullën "Tolerancë zero" përballë korrupsionit, që nënkupton qartë fuqizimin e shtetit juridik e sundim të ligjit. Përmes një fushate lufte kundër korrupsionit më se 1 milion nëpunës shtetërorë janë ndëshkuar dhe duzina nëpunësish të lartë janë arrestuar.

Ka shumë faktorë kompleks që ndikojnë direkt në arritjen e synimeve kineze të modernizimit të ndërlikuar. Nisur dhe nga retorika e përdorur në këtë moment nga Xi Ping, pyetja normale lidhet me çështjen se, në arritjen e këtij objektivit të rëndësishëm ndryshimi, si do të mund të harmonizohen edhe roli i PKK, edhe socializmi edhe modernizimi i Kinës? Si do të mundësohet funksionimi institucioneve demokratike e i demokracisë reale, si do të respektohen e do të mbrohen liritë e të drejtat e njeriut, si do të mundësohet sundimi i ligjit dhe shteti juridik, që janë pjesë esenciale të një shoqërie moderne? Xi Ping dhe ata që e mbështesin atë, e kanë të qartë faktin që Kina ka një kontradiktë të rëndësishme përpara për të zgjidhur, atë ndërmjet modelit politik-ekonomik aktual dhe nevojës së standardeve të plota të statusit të një superfuqie botërore. Kina ka nevojë të madhe për stimuj e mekanizma ekonomike e demokratike që të mundësojnë një zhvillim ekonomik të lartë e të qëndrueshëm, për mekanizëm drejtimi që nxit niasativën e lirë e pjesëmarrjen, ka nevojë për një ndryshim të plotë, që Xi Ping e cilëson modernizim.

Fjala është për një modernizim në kushtet e një shteti kaq të madh në territor e popullsi rreth dy miliardësh. Natyrisht, që Kina për arsye komplekse, nuk mund të imitojë modelin rus, por tash ndjehet ngushtë edhe ndaj modelit perëndimor edhe pse e kupton efektivitetin e tij. Ndryshimi e modernizimi në Kinë do të kërkojë kohë dhe do të ndikohet mjaft nga ato që njihen si veçori e karakteristika kineze. Një drejtim me dualizim parti-shtet, sic është sot, megjithë ndryshimet e pësuar në këto 40 vjet, që realisht kanë ruajtur balancat e brëndëshme, nuk mund të ketë jetëgjatësi dhe të sigurojë plotësimin e ambicieve të statusit e rolit të superfuqisë botërore.

Fakt është se Kina, vërtet ka një rritje ekonomike të qëndrueshme sot, por nuk ka një mekanizëm efektiv afat gjatë e sidomos që të plotësojë ambiciet e superfuqisë botërore. Kina ndjen nevojën e modelit të shtetit të së drejtës, ekonomisë funksionale të tregut, sundimit të ligjit dhe funksionimit të institucioneve demokratike. Xi Ping e ka kuptuar qartë këtë situatë, që mund të bëhet emergjencë, nëse nuk reagon. Po kështu, nëse Xi Ping nuk reagon ndaj kësaj kërkese zhvillimi, mund të dalë dhe vetë jashtë loje. Ajo që insiston Xi Ping, me nevojën e modernizimit, e përmban kërkesën, jo për axhustime, por tashmë për ndryshime cilësore të modelit të zhvillimit e të drejtimit, që do të prekin të gjithë elementët thelbësorë të modelit aktual. Modeli kinez është unik, por nuk është solid dhe efektiv për të mundësuar statusin e superfuqisë botërore. Nëse në vitin 2012 Xi Ping, që shihet si një reformator →

Opinioni / i Ditës

Nga Ferdinand Xhaferaj

(Vijon nga faqja e parë)

... në punët e drejtësisë duke vlerësuar si çorbë dosjen e prokurorisë Italiane. Ndërsa ministri i Brendshëm shkoi edhe më tej duke goditur politikisht organin e akuzës shqiptare.

Ndalimit të prishmëm të ish-ministrit Tahiri i paraprinë arrestimet e një bande të krimit të organizuar, që trafikonte drogë e armë drejt Italisë. Gjithçka u mundësua pas katër vjetësh hetime e katërqind e kusur faqesh evidencimesh të bëra nga prokuroria e vendit anëtar të Bashkimit Evropian.

Fillimisht, kreu i qeverisë dhe instrumentet e tij të propagandës u kujdesën ta kapsulonin problemin nën etiketën "e një druri të shtrëmbër në radhët e rilindjes". Por, druri ka marrë flakë dhe duket se do të djegë edhe qeverinë.

Themi kështu, sepse në dosjen voluminoze janë me shumicë episodet ku përmenden milionat e eurove që përfitojnë shtetarë e trafikantë shqiptarë për llogari të kërcënimit të sigurisë së Unionit. EUROPOL ka provuar se 65 për qind e organizatave të krimit të organizuar, që merren me trafikun e drogës, janë të përfshira edhe në aktivitetet të tjera kriminale që rrezikojnë sigurinë Evropiane.

Gjithashtu, në një nga bisedat e përgjuara midis trafikantëve bëhet e qartë se: "... Saimiri ka bërë minimumi 5 milionë euro në muaj. Ndërsa Sabi thotë se ai këto para i ka humbur në fushatën elektorale. Moisiu thotë që atij (Saimirit) nuk i mjaftojnë as 20 milionë në një fushatë elektorale". Pra, trafikantët riaplikojnë për shumën e parave që nevojitet në fushatë elektorale, por bien dakord se paratë e trafikantit janë përdorur në zgjedhjet shqiptare.

Rama po përballlet me një thikë me dy presat duke qenë se edhe ka prishur legjitimitetin e zgjedhjeve Shqiptare, edhe ka bezdisur radarrë të sigurisë Evropiane.

Muaj më parë ambasadorë dhe zyrtarë të rëndësishëm të Perëndimit, për hir të stabilitetit të Shqipërisë, dhe për domosdoshmëri të funksionimit të demokracisë

Perëndimi, jo me dy standarde për Edvinin



detyruan Bashën të sakrifikohej me zgjedhje.

Perëndimi tashmë është i detyruar të ruajë standardin e vendosur në prag të zgjedhjeve të qershorit. Kujtojmë se në maj të 2017-ës, ambasadorja gjermane në Tiranë, Susanne Schutz do të deklaronte: "Nëse Partia Demokratike dhe partitë e tjera opozitare vazhdojnë t'i mbeten qëndrimit të tyre për të mos marrë pjesë, ky do të jetë një vendim i trishtueshëm për ne. Por ne do t'i njohim këto zgjedhje".

Pak më herët, në prill të 2017-ës, ambasadori Lu, duke folur për "Zërin e Amerikës" bënte me dije se "Është e vërtetë që zgjedhjet

mund të konsiderohen të ligjshme dhe legjitime edhe pa pjesëmarrjen e opozitës".

Opozita kishte muaj që deklaronte se nuk bëhej fasadë e zgjedhjeve që blihen me paratë e krimit. Ajo u detyrua të braktiste bojkotin, sepse nuk donte të braktiste Perëndimin.

Ndërkombëtarët tashmë duhet të respektojnë dhe zbatojnë standartet që imponuan vetëm pak muaj më parë. Imuniteti dhe fati i Tahirit është çështje institucionesh shqiptare. Por fati dhe imuniteti i qeverisë është edhe çështje institucionesh Evropiane.

Në krizat e vendeve të Ballkan-

it, sikurse diskutohet nga studiues të shkencave politike, përgjithësisht Perëndimi ka ndërhyrë jo në kohën e duhur dhe jo me cilësinë e duhur.

Rama mund të vazhdojë të hyje e të dalë nga zyra sikurse Tahiri hyn e del në emisione televizive, por kjo është thjesht zvarritje që mund të marrë zvarrë edhe stabilitetin e vendit.

Pra, nëse Rama do vazhdojë me këmbëngulje të drejtë një qeveri jo-legjitime, opozita nuk mund të bashkëpunojë shumë gjatë me Kuvende jo-legjitime. Opozita do të shkojë drejt radikalizimit. Dhe e ka të gjithë të drejtën të bëjë këtë.

ekonomik, fliste për "ëndrën" më të madhe të Kinës, tash shihet si një lider shumë i fuqishëm, që ka në vizionin e tij sentencën reformë dhe hapje të Kinës, duke ruajtur balancat e pushtetit mes rolit të partisë dhe qeverisë. Ai vërtetë nxiti aktualisht kryeministrin të kryejë reformat dhe ndryshimin, por nxiti dhe strukturat e partisë në drejtim të politik bërjes.

Më pas do të shihet se si do të ndryshojë ky dualizëm apo marrëdhënia parti-shtet, aq më tepër po të mbahet parasysh fakti se Xi ka tashmë mbështetje të fortë edhe nga partia dhe nga populli kinez, që do të mundësojë punën për modernizimin e Kinës dhe sigurimin e statusit të superfuqisë botërore. Megjithatë, ka dhe analistë që e shohin me shqetësim këtë fuqizim të pushtetit të Xi Ping edhe pas kongresit, duke menduar

se tashmë, duke përdorur dhe armën e partisë, autoritarizmi i tij do të dëmtojë zhvillimin e standardeve demokratike e të shtetit juridik. Në këtë shqetësim ata llogarisin edhe një axhendë nacionaliste. Madje ndonjë flet edhe për një lloj neototalitarizmi të mundshëm dmth që mendojnë mundësinë e përdorimit të pushtetit për të plotësuar ambicionin e superfuqisë botërore.

Xi Ping është shfaqur konstruktiv në marrëdhëniet me aktorët kryesorë të sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ka bërë prezent disa ide për rolin botëror të Kinës dhe është afishuar në mbështetje të globalizimit, sic deklaroi në samitin e fundit të Davosit. Ai ka nënvizuar nevojën për një rend të ri botëror racional, por ka evidentuar qartë ambiciet e Kinës për superfuqi botërore, duke bërë hapa konkretë me zhvillimin

e kapaciteteve ushtarake apo me ishujt artificialë në Paqësor; hapjen e një baze ushtarake jashtë Kinës, apo duke marrë pjesë në stërvitje ushtarake bashkë me Rusinë në Mesdhe, por dhe në rajonin e Balltikut. Kina ka shfaqur qartë një lloj ekspansionizmi ekonomik botëror; në Afrikë, A. Latine, por dhe në Europë e veçanërisht në Ballkan. Kina ka nevojë të brëndëshme që të ndryshojë e modernizohet, por dhe zhvillimet botërore kanë nevojë për ndryshimin e modernizimin e Kinës e rolin konstruktiv të saj.

Kina tashmë është aktor tepër i rëndësishëm në sistemin emarëdhënieve ndërkombëtare, por statusi i superfuqisë botërore është cilësi tjetër, ku Kina do të rivalizojë fort e të ndajë fuqinë me SHBA, aq më tepër, kur disa lëvizje të SHBA, janë vlerësuar nga analistë të ndryshëm, se po krijohen

boshllëqe, sa i përket fuqisë e rolit në zhvillimet botërore. Gjithsesi Kina është treguar e kujdesshme, bashkëpunuese e jo e grindur në këtë drejtim. Ndoshta ky qëndrim lidhet edhe me nevojat e plotësimin të standardeve të superfuqisë botërore, ku çështja e Taivanit është e rëndësishë së veçantë. Gjithësesi, vizita e ardhëshme e presidentit amerikan Trump në Kinë mer rëndësi të veçantë, për të kuptuar më mirë ambiciet e Kinës dhe cilësinë e marrëdhënieve të saj me SHBA. Zgjidhja e krizës koreano veriore, synimi për të frenuar programin e saj bërthamor dhe aventurizimin, parandalimi i një përplasje ushtarake me SHBA dhe Koresë së Veriut, duket se do të tregojë shumë, jo vetëm për cilësinë e bashkëpunimit të saj me SHBA, por edhe gadishmërinë e mundësinë reale të Kinës për një rol, jo vetëm rajonal, por edhe botëror.

HOROSKOPI

DASHI

Do të keni krijimtari të shkëlqyeshme në punë. Originaliteti i bashkëngjitet çdo nisje. Nën drejtimin tuaj edhe gjëja më e parëndësishme ka personalitet. Me kolegët formoni një ekip të ngushtë që beson në bashkëpunim dhe që përballlet me sfidat.

DEMI

Të pakënaqur nga Hëna, si edhe me Venusin e burgosur në shtëpinë tuaj të dymbëdhjetë, për sot nuk bëhet fjalë për aventura dashurore! Si kompensim, mështëtja e Diellit dhe Plutonit hap rrugën për një miqësi të veçantë, intensive dhe intime.

BINJAKET

Venusi dhe Hëna janë të gatshëm që t'ju inkurajojnë dhe t'ju japin një dozë vetbesimi. Do të keni marrëdhënie të qetë me ambientin që ju rrethon. Pas një saqarimi, jeta në çift do të bëhet më e ëmbël, partneri do të jetë më pak i ngurtë dhe do të këtë më shumë mirëkuptim.

GAFORJA

Revolucionarë të zemrës, synoni harmoninë që zbut mosmarrëveshjet, duke filluar nga jeta në çift, ku komunikimi bëhet jetik. Dëshirat shumëfishohen nga Venusi, kështu që, në modë dhe produkte kozmetike do të bëni shpenzime të mëdha.

LUANI

Në çifte do të jeni të lumtur dhe të kënaqur, si në përallat! Rregulli i juaj është të balancoheni për çdo gjë, por pa e ngritur zërin, me dashmiresi dhe diplomaci. Do të vendosni të ndërmerrni një udhëtimin në fundit, për të festuar një përvjetor dashurie ashtu siç duhet!

VIRGJERESHA

Do të keni momente magjike në punë, ku çdo gjë ecën në përsosmëri, të frymëzuar nga një fillad gjeniu krijues dhe të mbështetur nga shija tuaj estetike. Është dita ideale për ata që merren me modën, bukurinë dhe mirëqenien, por edhe për ata që punojnë për marrëdhëniet me publikun.

PESHORJA

Venusin do ta keni kundra, por nuk ju sjell ndërkohë. Ndërkohë, e mbështetur nga aspekti pozitiv i Hënës, njëjtë në pak interes reciprok. Do të jeni të lumtura dhe të kënaqur, aq sa të ndryshoni qëndrimin duke iu hapur dhe degjatur nevojat dhe dëshirat e partnerit.

AKREPI

Keni një familje të dashur dhe fëmijë të mirë, por ju mungon diçka, dhe madje shumë, një person nga e kaluara që ende nuk arrini ta harroni. Është e nevojshme të ndryshoni menjëherë dietën. Efektet e para do të jenë të dukshme në lëkurë, e cila do të jetë më e shkëlqyer dhe e butë.

SHIGJETARI

Nëse jeni të dashuri, do të shikoni pak përtej arsyes, do të bëni sjellje të çuditshme, do të bëni deklarata dramatike, do të argoni ëmbëlsi të pakufishme për personin që ju tërheq. Sot do të jeni në humor të mirë dhe do të keni fat në veprimtaritë që ndërmerrni.

BRICJAPI

Hëna do të jetë e heshtur dhe Venusi do të jetë tekanjor, sot dashuria nuk ecën. Ndërkaq, një ngushëllim dëshja Diell-Pluton, garantuese të një atmosferë miqësore dhe të shndritshme. Financat duhet t'i keni në vëmendje, dhe ju takon vete të bëni vlerësimin e duhur për të mos shpenzuar shumë.

UJORI

Njënjat në çift janë të forta, por përsëri nuk është e mjaftueshme. Nëse partneri përpiqet t'ju fusë në "kurth" duke ju folur për të ardhmen, ju bëni menjëherë një hap pra. Do të keni kontakte të shpejta dhe fitimprurëse. Nëse i keni mbyllur punën e javës, vazhdoni përpara me veprimtari të tjera.

PESHQIT

Hëna e zellshe do të jetë duke ju mbikëqyrur, ndërsa Venusi ju rekomandon blerjen e sendeve të shtrënjta, duke ju bindur se prestigji dhe suksesi ecin krah për krah. Në punë do të jeni energjikë falë dyshes Diell-Pluton.



Krahasimi i gazetarit Alçato

"Sky Sport": Hysaj? Si një palë xhinse, i gatshëm kurdoherë

Paraqitjet e shqiptarit në Serinë A kanë qenë gjithmonë të lavdërueshme dhe Elseid Hysaj është bërë prej dy vitesh i pazëvendësueshëm në skuadrën që është duke tentuar fronin e futbollit italian. Pas ndeshjes Napoli-Inter, gazetari i "Sky Sport", Alessandro

Alçato, ka bërë një krahasim mes mbrojtësit të Kombëtares shqiptare me atë të Kombëtares italiane. "Hysaj apo D'Ambrosio? Shqiptari është si një palë xhinse. I vesh në të gjitha rastet. Edhe nëse bëhet fjalë për të luajtur në ndeshjen Empoli-Salernitana, edhe nëse

bëhet fjalë për Mançester Siti-Napoli, ka të njëjtin përqendrim dhe impenjim. Nga ana tjetër, internisti është si një palë tuta për punë. Në këtë rast, varet çfarë të pëlqen më tepër. Unë personalisht preferoj xhinset", ka deklaruar gazetari i "Sky Sport".

DO LUHET NË TRI DITË



Përcaktohet kalendari për javën e 8 të Superligës

Federata Shqiptare e Futbollit ka publikuar kalendarin e javës së 8-të të Kategorisë Superiore, e cila do të nisë me dy sfida të ditës së shtunë, ku në orën 14:00 Lushnja do të presë skuadrën e Teutës dhe më pas në orën 17:00, kryesuesja e kampionatit, Skënderbeu, do të presë në Korçë ekipin e Luftëtarit. Të dielën do të ketë dy sfida interesante, ku në orën 14:00 kampionët në fuqi, Kukësi do të presë në stadiumin "Zeqir Ymeri" skuadrën e Vllaznisë. Në të njëjtën ditë, në orën 17:00 në stadiumin "Selman Stërmasi" do të luhet përballja më e bukur e kësaj javë, e ku skuadra e Partizanit do të luajë ndaj Flamurtarit, e cila është duke kaluar një moment të shkëlqyer dhe duket se është rikthyer për të synuar zonën e lartë të tabelës këtë sezon. Dhe sfida e fundit e kësaj jave do të luhet të hënën në orën 14:00 në stadiumin e qytetit të Laçit, ku kurbina-sit do të presin surprizën e këtij sezoni, Kamzën.

Ish-lojtari i Kombëtares deklaron se nuk afron kurrë në ekip lojtarë që nuk përshtaten me grupin



Jeton Selimi

Tare bën 'rezonancën' e Lacios: Inzagi është ende një trajner i ri
Drejtori Sportiv është i kënaqur me performancën

Drejtori Sportiv i Lacios, Igli Tare së fundmi ka dhënë një intervistë për "Corriere di Bologna", ku ka folur për skuadrën bardhekaltrë duke rrefyer edhe disa nga sekretet e punës së tij. Fillimisht ai komentuar zgjedhjen e Simone Inzaghit në krye të ekipit. "Kush e donte atë në stol? Çdo gjë te Lacio është e ndarë dhe çdo gjë te Lacio kalon përmes presidentit. Gjithmonë kam menduar se ai ka kualitete të mëdha. Simone është shumë i zot, por është ende i ri, dhe futbollit ka uljet dhe ngritjet e veta. Ai i kam dhënë futbollistë të mirë? Gjithmonë përpiqem që t'i bëj gjërat me logjikë, zgjedh futbollistë që mund të bëjnë mirë në futbollin e sotëm. Vlerësoj si karakterin, ashtu edhe karakteristikat e tyre në fushë. Për të ndërtonar një skuadër nuk duhet të harrosh disa gjëra. Këdo që marrim duhet ta integrojmë me të tjerët, sepse grupi është para çdo gjëje. Dhe njëkohësisht e rëndësishme është edhe se si sillemi me të", ka thënë Igli Tare, duke demonstruar se pas suksesit të tij qëndron puna e madhe e



bërë kryesisht për të mbajtur grupin e bashkuar. Igli Tare vlerësohet në Itali nga mediat, si drejtoi sportiv më i mirë. Tare ka arritur që të marrë lojtarë me çmime të ulëta dhe t'i shesë ata me shifra të bujshme. Por, përveç përfitimëve monetare, "biondi" ka arritur që të krijojë një Lacio

shumë të fortë dhe pretendente. Igli Tare e nisi karrierën si futbollist me ekipin e Partizanit, ku shkëlqeu që në moshë të re dhe menjëherë kaloi në Gjermani. Pas dy sezonesh me VfL Wolfsburg dhe Ludwigschafen, Tare siguron një kontratë të mirë me Kallsruhen, një nga ekipet më me traditë në

Gjermani. Katër sezona të ndara mes Fortuna Düsselndorfit dhe Kaizerslauternit dhe më pas kalimi në Itali. Te Breschia "giganti i mirë" bëhet pikë referimi, ku shndërrohet në partnerin fikse e një legjende si Roberto Baxho. 15 gola në Lombardi për Taren në dy sezona, por asiste pa fund për

68
NDESHJE
Me fanellën kuqezi ka luajtur Igli Tare, ndërsa në karrierën e tij me klubet plot 330 ndeshje, nga të cilat 54 me fanellën e ekipit të Lacios.

Baxhon, që arriti të fitonte dhe "Këpuçën e Artë" në edicionin 2001-2002. Te Bologna, Tare do të zëvendësojë Hulo Rikardo Kruzin dhe do ta mbyllë karrierën të Lacio në vitin 2008 dhe menjëherë u bë team-manager i ekipit për t'u emëruar drejtor sportiv një sezon më pas, rol të cilit e mbulon edhe sot.

SUPERLIGA	
JAVA E 8-TË	
E SHTUNË	
Lushnja-Teuta	14:00
Skënderbeu-Luftëtarit	17:00
E DIEL	
Kukësi-Vllaznia	14:00
Partizani-Flamurtari	17:00
E HËNË	
Laçi-Kamza	14:00

PËRGJEGJËSI PËR 3 HUMBJET RADHAZI

Teuta votëbeson Maganin, trajneri vijon detyrën

Katër humbje dhe vetëm një pikë e marrë në pesë ndeshjet e fundit. Teuta e këtij sezoni kaloi nga starti i ëndrrave, ku madje u guxua të flitej për një skuadër që do të rivalizonte pretendentët, në makthin e zonës së rënies nga kategoria. "Jam i hapur për çdo vendim të presidentit pas tri humbjeve. Është trajneri, ai që mban përgjegjësi edhe pse gabimet i bëjnë lojtarët që luajnë". Deklarata e trajnerit, dhënë në emocionin "Gol Pas Goli", menjëherë pas humbjes 4-1 në shtëpi me Skënderbeun, vendosi në lëvizje klubin, që konfirmoi Maganin në krye të stolit. Në qëndrim e zyrtarëve të Teutës, mbështetja e pakushtëzuar për teknikun lidhet me faktin se klubi, ashtu si edhe skuadra, janë ende në procesin e rindërtimit dhe për këtë nevojitet kohë. Kur po afron fundi i fazës së parë në Kategorinë Superiore, skuadra bregdetare ka grumbulluar vetëm shtatë pikë dhe pozicionohet në vendin e shtatë në renditje, e ndjekur nga afër nga Vllaznia dhe Luftëtarit, që rezikojnë në zonën e mbijetesës.



SULMUESI U HAP DERËN KLUBEVE TË TJERA

Trondit Roish: Po mendoj largimin nga Dortmundi

Marko Roish mund të lërë Borussia-n e Dortmundit këtë sezon. Trekuartisti gjerman ka folur pikërisht për të ardhmen e tij në një intervistë duke deklaruar: "Janë duke më kërkuar 4-5 skuadra në Evropë, ku do më pëlqente të luaja. Më 31 maj 2019 do të jem 30 vjeç, dhe më shumë mundësi kontrata e ardhshme që do të firmos do të jetë kontrata e jetës dhe do të jetë mundësia e fundit që mund të provoj diçka të re. Të jem i singërt, nuk e di as vetë se ku klub do të transferohem. Për momentin jam i lumtur këtu në Dortmund dhe nuk e mendoj se çdo të ndodhë në vitin 2019. Por, sigurisht kur të vijë momenti do ta mendoj dhe do ta zgjidh me qetësi", përfundoi gjermani Marko Roish.




HABIT LEGJENDA

Maradona: Më dhemb shpirti kur ia dorëzova çmimin Ronaldos

Legjenda argentinase, Diego Armando Maradona, pas ceremonisë së organizuar nga FIFA për të nderuar më të mirët e sezonit të kaluar, është shprehur se është ndër të pikëlluar kur i ka dorëzuar çmimin si lojtar më i mirë i vitit Kristiano Ronaldo, kur në garë ishte edhe Leo Mesit, dhe në fakt nuk kishte mundësi t'ia dorëzonte bashkëkombësit të tij. "Më dhembin shpirti kur i dhashë çmimin e më të mirit Ronaldos dhe nuk kisha mundësi t'ia jepja Mesit". Sidoqoftë, pasi u takua me Mesin, Maradona tha: "Takimi me të ishte fantastik. Fola me të dhe mes nesh ekziston e njëjta dashuri, siç ka qenë gjithmonë". Kujtojmë se Mesit është kritikuar nga shumë argentinase për paraqitjet e tij me kombëtaren, edhe nga vetë Maradona, për mungesë personaliteti si lider kur mban veshur fanellën e Argentinës.



Fjalëkryqi (1)



- VERTIKAL**
- Të çara ato të Shollohov.
 - Fillojë luftën.
 - Liszt kompozitor.
 - Marsi në Areopag.
 - Kështu fillon filmi.
 - Gjysmë linear.
 - Një freskues në tavan.
 - Eshhtë gazeta Panorama.
 - Mund të jenë kamikaze.
 - Masat pa kufij
 - Venier e spektaklit italian.
 - Sophia e kinemasë.
 - Safin tenis.
 - Eshhtë makut, i pangopur.
 - Eshhtë faqe ene.
 - Një kafshë qe hap... galeri.
 - Një fytyrë e keqe.
 - Preken nga sindroma Basedow.
 - Italia në Internet.

- Fillojnë vonë.
 - Krijoi James Bond.
 - Ishulli i Odiseut.
 - Van der portier.
 - Një karamelle aromatike.
 - Mund të shkojnë... nga frika.
- VERTIKAL**
- Bëhet duke vënë në lojë.
 - Pak origjinale.
 - Thahet me bonifikim
 - Në fund djathtas.
 - Ishte Gjermania e Honecker-it.
 - Hidhet një për shesh.
 - Kokëkuqja në pit stop.
 - I famshëm ai i Sizifit.
 - Eshhtë në pikën më veriore e Shqipërisë.
 - Një diktator shtypës
 - Lëvizja Socialiste Spanjole.
 - I kanë çift radhët.
 - Janë llahtarë.
 - Poeti kur nuk pi.
 - Fillojnë periudhën.
 - Omar që qe aktor.
 - Si sezonale.
 - Janë banorët në Riga.
 - Carey këngëtare.
 - Nuk i tregohen babait.
 - Bëjnë arte me re.
 - Kush ka... e ka humbur toruan.
 - Një stacion orbital.
 - Fillojnë profesionin.
 - Gibernau i MotoGp.
 - I kanë të ndryshme tutat
 - Gjysmë ditari.
 - Varet me re.
 - Kufijtë e kujtesës.
 - Sapo fillonjë.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

- Gustav kompozitor.
- Në krye të kryesisë.
- Lexohet në pentagram.
- Sastre aktore.
- Gjysmë akordi.
- Dhjetë angleze.
- Satira për zë.
- Eshhtë situata e tensionuar.
- Pak teatrale.
- Bëhet me mea culpa.
- Fundi i një samurai.
- Mbeten në fund.
- Lind në kokë.
- Në radhë të parë.
- Iniciale e Camus.
- Një verë në Paris.
- Partizani i vogël... në një film tonin.
- Litra pa kufij.
- Eshhtë fatë.
- Një pjesë e kinematografisë.


VERTIKAL

- Janë enigmatikë.
- Mund të jenë paraboliqe.
- Ishte xhelozia e Olimpik.
- Kufijtë e lëvizjes.
- Fillojnë radhijten.
- Janë kushte.
- Totem pa ekstreme.
- Mbyllin kanate.
- Shoqëronte Edipin e verbër.
- Eshhtë gjeli.
- Moore aktore.
- Janë forcat e Reneas.
- Janë përmasa.
- Fundi dhjetori.
- Mbyllin dritaren.
- Fillojnë matjet.
- Duhet ruajtur.
- I bën një serenatë Rosina-s.
- Gjysmë rabini
- Mustafa.. Ataturk.
- Të parat në Amsterdam.
- Ai i muzave është Helikona.
- Një pjesë e gadishullit
- Muzika e Eminem.
- Fillojnë operacionin.
- Kapen të parat.
- Kufijtë e drejtëzës.




- Të çara ato të Shollohov.
- Fillojë luftën.
- Liszt kompozitor.
- Marsi në Areopag.
- Kështu fillon filmi.
- Gjysmë linear.
- Një freskues në tavan.
- Eshhtë gazeta Panorama.
- Mund të jenë kamikaze.
- Masat pa kufij
- Venier e spektaklit italian.
- Sophia e kinemasë.
- Safin tenis.
- Eshhtë makut, i pangopur.
- Eshhtë faqe ene.
- Një kafshë qe hap... galeri.
- Një fytyrë e keqe.
- Preken nga sindroma Basedow.
- Italia në Internet.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		4	5		3	1			
2	3			4	6	7			
6						3		5	
8	5		3	9					
	4		8		1	2			
				6	2		8	7	
5		9							1
		8	9	7				3	6
		7	2		8	4			

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	1	4	6	5	8	2	3	7	
7	8	5	1	3	2	4	9	6	
6	3	2	9	4	7	8	1	5	
5	4	3	7	2	1	6	8	9	
2	9	7	3	8	6	5	4	1	
1	6	8	4	9	5	7	2	3	
8	2	6	5	1	3	9	7	4	
4	7	1	2	6	9	3	5	8	
3	5	9	8	7	4	1	6	2	



Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- "I mundur nuk është ai që humb, por ai që dorëzohet".
- "Vullneti është ai që të bën të fitosh atëherë kur logjika të thotë se ke humbur". **Carlos Castaneda**
- "Ashtu sikurse ata që ecin në diell ndiqen nga hijja e tyre, kështu dhe ata që janë njerëz me vlera ndiqen nga lakmia e të tjerëve". **Sokrati**
- "Njeriu gjeni mund të qeshë me gjithçka, ndërsa njeriu logjik nuk mund të qeshë gati me asgjë". **Gëte**

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

ARKANA ASTROAMA
DIANA ANTIK
ATLANTIKE OLS
PEITARI FATALE
TITPOLITIKANET
KENETI ORANET
PAULINRIRI
ARUOTAADDIM
RUMUNENIEMERAN
ETJITIERITAMANE
TEIITGORDIANE
INTAROMATIET

FJALËKRYQI (2)

PABMELERGO
KUPAEMIRATE
OHARAAROMAT
CIKLINSTEIT
STADIUMETAPFEL
DIKASTERERUE
KENTNGOPJEV
KAIASITIESE
MARINIOLANORE
MASSIMOZANORE
AMANNANNE
TIERRENTIETINE



Thënie të mençura

- Asnjë nuk është e vogël për një mendje të madhe. **(Sherlok Holms)**
- Më pëlqejnë ata që mund të buzëqeshin në telashe, ata që mund të fitojnë fuqi nga stresi dhe që bëhen të zotë, duke reflektuar. **Da Vinci**
- Ka diferencë të madhe midis pëlqimit dhe dashurisë... Nëse të pëlqen një lule e këput menjëherë, ndërsa kur e do e 'ujt' dhe përkujdesesh për të gjithmonë... **Populli**
- Fëmijet gjejnë gjithçkanë në asgjë, kurse të rriturit asgjë në gjithçka! **(Giacomo Leopardi)**

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

